



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 131

Tiranë – E enjte, 7 shtator 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 191, datë 4.9.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 15543
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 23, datë 17.11.2022	Për modelin e kontratës për kontraktimin e performancës së energjisë.. 15543
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 216, datë 4.9.2023	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 15566



DEKRET
Nr. 191, datë 4.9.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 9, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare me kërkesë të shtetasve të mëposhtëm:

1. Arlind Ibrahim Ibrahim Rexhepi
2. Enis Esref Asani
3. Edon Faruk Pruti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 23, datë 17.11. 2022

PËR MODELIN E KONTRATËS PËR
KONTRAKTIMIN E PERFORMANCËS
SË ENERGJISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit 9000/2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 5, të nenit 18, të ligjit nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi, është:

1. Promovimi i zhvillimit të tregut kombëtar të shërbimeve të energjisë në Republikën e Shqipërisë, duke përcaktuar rregullat dhe procedurat për

operimin e shoqërive të shërbimeve të energjisë (ESCO).

2. Krijimi i modelit të kontratës së performancës së energjisë që do të rregullojë veprimtarinë ndërmjet personave juridikë, që sigurojnë shërbimet energjetike për përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe personave fizikë dhe/ose juridikë, publikë ose privatë, që janë konsumatorë fundorë të energjisë (klientëve) mbi kushtet dhe procedurat e bashkëpunimit për të zbatuar masat që reduktojnë konsumin e energjisë dhe kostot në një mënyrë të qëndrueshme teknikisht dhe financiarisht.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për çdo person fizik apo juridik që ushtron veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të energjisë ose masave tjera për uljen e konsumit të energjisë në objektin ose ambientet e konsumatorit fundor, me qëllim përmirësimin e eficiencës së energjisë.

Neni 3

Përkufizime

Ministria nënkupton ministrinë përgjegjëse për energji;

Agjencia për Eficiencën e Energjisë është institucioni përgjegjës për promovimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave dhe të politikave të eficiencës së energjisë.

Kontrata e performancës së energjisë është një lloj marrëveshjeje kontraktuale afatgjatë ku klienti përfiton nga pajisjet e reja ose të përmirësuara të energjisë dhe shpërblimi i ESCO-ve është i lidhur drejtpërdrejt me kursimet e arritura në sasinë e energjisë së kursyer nga projekti.

MKE janë masat e kursimit të energjisë.

Shoqëria e Shërbimit të Energjisë (ESCO) është shoqëri e cila duhet të jetë e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), e specializuar në kryerjen e shërbimeve energjetike, ku drejtuesi teknik i shoqërisë duhet të jetë auditues energjetik i certifikuar dhe që angazhohet në një kontratë të bazuar në performancë me një firmë klienti për zbatimin e MKE-së (masat e kursimit të energjisë) dhe reduktimin e kostove në një mënyrë të qëndrueshme teknikisht dhe financiarisht.



Klientë janë personat fizikë dhe/ose juridikë, publikë ose privatë, që janë konsumatorë fundorë të energjisë (klientë) që do të përmirësojnë përdorimin eficient të energjisë në ndërtesën në pronësi apo të kontraktuar.

Ndërtesa e kontraktuar është ndërtesa në të cilin zbatohen MKE-të dhe që mund të përbëhet nga disa objekte dhe/ose sisteme teknike dhe teknologjike, të gjitha të përdorura nga Klienti.

Përmirësimi i eficiencës së energjisë – do të thotë, rritje e eficiencës së energjisë si rezultat i ndryshimeve në teknologji, sjellje apo ekonomi.

Periudha kontraktuale nënkupton periudhën nga nënshkrimi i kësaj kontrate dhe hyrja e saj në fuqi deri në përfundimin e saj.

Periudha e zbatimit është një periudhë e kryerjes së aktiviteteve të ndryshme të lidhura me zbatimin e MKE-së që duke përfshirë ndër të tjera ndërtimin, zgjerimin, përmirësimin e parametrave, adaptimin dhe rehabilitimin, si dhe montimin/instalimin dhe komisionimin e instalimeve, pjesëve të tyre, ose pajisjeve dhe/ose programeve kompjuterike në shoqërinë e kontraktuar që lidhen me zbatimin e MKE-së.

Periudha e garancisë nënkupton periudhën e kohës që varion nga përfundimi i periudhës së zbatimit deri në përfundim të periudhës kontraktuale.

Matja dhe verifikimi (M&V) janë aktivitetet dhe procedurat e kryera për të përcaktuar në mënyrë të besueshme kursimet aktuale të energjisë dhe kursimet financiare që i atribuohen aktiviteteve të zbatimit.

Pagesa vjetore bazë është e barabartë me kursimet vjetore të garantuara (në rastin e kursimeve të ndara, pagesa vjetore bazë barazohet me kursimet vjetore të garantuara të shumëzuara me përqindjen e kontraktuar të kursimeve të ndara për Kontraktuesin).

Kursimet vjetore të garantuara janë të barabarta me kursimet e garantuara të pjesëtuara me numrin e viteve të periudhës së garancisë.

Kursimet vjetore janë kursimet e arritura financiare, siç llogariten në raportin e aprovuar të M&V për një periudhë llogaritjeje specifike gjatë periudhës së garancisë.

Periudha e raportimit nënkupton çdo periudhë kohe pas zbatimit të një MKE për të cilën përgatiten raportet e kursimit. Kjo periudhë mund të jetë aq e shkurtër sa koha për një matje të

menjëhershme të një sasie konstante, e gjatë mjaftueshëm për të reflektuar të gjitha mënyrat normale të funksionimit të një sistemi ose objekti me operime të ndryshueshme. Ajo mund të jetë kohëzgjatja e periudhës së garancisë, kohëzgjatja e periudhës së matjes së performancës (mbi bazë vjetore ekuivalente me periudhën e llogaritjes) sipas kontratës model bashkëlidhur.

Regjistër databazë e të dhënave në AEE, ku janë të regjistruara shoqëritë që operojnë në fushën e shërbimeve të energjisë;

Shprehjet tjera të përdorura në këtë udhëzim kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në ligjin nr. 124/2015, “Për eficiencën e energjisë”, i ndryshuar.

Neni 4

Kushtet e operimit të shoqërive të shërbimeve energjetike (ESCO)

1. Shërbimet energjetike ofrohen nga shoqëri të specializuara (ESCO), të cilat duhet të jenë të regjistruara në QKB. Drejtuesit teknikë të shoqërive që ofrojnë shërbimet energjetike duhet të jenë auditues energjetikë të certifikuar.

2. shoqëritë e shërbimeve të energjisë janë të detyruara të garantojnë:

a) kapacitete të nevojshme teknike, menaxheriale, ligjore dhe financiare për të ofruar shërbime të energjisë për klientët;

b) përmirësime të eficiencës së energjisë në përputhje me kushtet e kontratës për shërbimet e energjisë;

c) zbatimin e masave të synuara të eficiencës së energjisë;

d) arritjen e kursimeve të paracaktuara të energjisë dhe përfitimeve ekonomike të llogaritura në fazën kontraktuale;

e) marrjen përsipër të rreziqeve teknike dhe financiare për të arritur kursimet e energjisë të dakordësuara paraprakisht;

3. Kapaciteti teknik i një shoqërie të shërbimeve të energjisë përcaktohet nga:

a) periudha gjatë së cilës ka ofruar shërbime të energjisë;

b) numri i punonjësve të shoqërisë apo bashkimit të shoqërive, në rastin e një partneriteti, që kanë përvojë në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e përmirësimeve të eficiencës së energjisë;



c) numri i kontratave të shërbimeve të energjisë, të cilat i ka nënshkruar, zbatuar ose ka marrë pjesë në zbatimin e tyre.

Neni 5

Shërbimet që ofrohen nga shoqëritë e shërbimeve energjetike (ESCO)

1. Shoqëritë e shërbimeve energjetike ofrojnë shërbime energjetike për klientët, si:

a) instalimin, funksionimin, zëvendësimin, përmirësimin, mirëmbajtjen dhe/ose rregullimin e parametrave të operimit të pajisjeve energjetike, sistemeve të ndriçimit dhe mjeteve të transportit;

b) instalimin, operimin, zëvendësimin, përmirësimin dhe/ose mirëmbajtjen e sistemeve të prodhimit të energjisë ose sistemeve të energjisë nga burimet e rinovueshme që janë me eficientë në aspektin e energjisë; përmirësimin e pjesshëm ose të plotë energjetik të mbështjelljes së ndërtesave;

c) instalimin dhe operimin e sistemeve të integruara të kontrollit dhe menaxhimit të energjisë; dhe

d) çdo masë tjetër që kontribuon në rritjen e kursimit të energjisë;

2. Shoqëritë e shërbimeve energjetike mund të ofrojnë edhe shërbime të tjera të energjisë, si:

a) këshilla nga ekspertët për përzgjedhjen e masave alternative për përmirësimin e eficientës së energjisë;

b) inspektim githëpërfshirës energjetik dhe auditim të ndërtesës së një konsumatori;

c) mirëmbajtje të pajisjeve energjetike.

d) zbatim të sistemeve të menaxhimit të energjisë sipas standardeve të BE-së dhe atyre të pranueshme ndërkombëtare;

e) ofrim të trajnimit dhe edukimit për klientët/konsumatorët fundor mbi përdorimin racional të energjisë dhe menaxhimin e energjisë.

3. Shoqëritë e shërbimeve energjetike duhet të vlerësojnë dhe verifikojnë çdo përmirësim të zbatuar të eficientës së energjisë përmes:

a) përcaktimit të gjendjes fillestare referuese të energjisë për matjen dhe analizimin e konsumit aktual të energjisë nga klientët;

b) vlerësimin e masave të propozuara të eficientës së energjisë, përfshirë përfitimet e tyre përkatëse individuale, teknike dhe ekonomike;

c) zbatimin e një plani për matjen dhe verifikimin e kursimeve reale të energjisë që

planifikohet të rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve të energjisë;

d) monitorimin e progresit në zbatim të masave të propozuara për eficientën e energjisë dhe rezultatet e arritura sipas kontratës përkatëse të shërbimeve të energjisë;

e) dorëzimin e raportit të progresit të klientët në intervale të dakordësuara, të cilat përfshijnë informacion të detajuar për nivelin e kursimeve të energjisë dhe përfitimet ekonomike të arritura krahasuar me nivelet e përcaktuara në kontratën përkatëse të shërbimeve të energjisë.

Neni 6

Kriteret për kryerjen e shërbimeve të energjisë

1. Për të siguruar kryerjen e shërbimeve të energjisë, çdo shoqëri e shërbimeve të energjisë mund të vendosë procedura specifike të bazuara në praktikat më të mira përkatëse të BE-së dhe ato ndërkombëtare, si:

f) adoptimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilësisë sipas legjislacionit në fuqi;

g) zbatimi i një sistemi certifikimi në përputhje me standardet evropiane;

h) analiza e kostove të investimeve dhe operimit së secilës masë të propozuar të eficientës së energjisë sipas kontratës model, të aprovuar;

i) vlerësimi i rreziqeve teknike, ligjore dhe financiare në lidhje me çdo masë të propozuar të eficientës së energjisë dhe metodat për mbulimin efektiv të këtyre rreziqeve sipas kontratave model;

j) përdorimi i mekanizmave të ndryshëm për financimin e masave të propozuara të eficientës së energjisë, si financimi nga palët e treta.

2. Shoqëritë e shërbimeve të energjisë mund të ofrojnë shërbime të energjisë për konsumatorët fundor drejtpërdrejtë apo indirekt, duke e nënkontraktuar te palët e treta një pjesë të ofrimit të shërbimeve të tilla.

Neni 7

Detyrimet e shoqërive të shërbimeve të energjisë

1. Për të garantuar funksionimin e duhur të tregut dhe për të ruajtur cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimeve energjetike që u ofrohen klientëve, shoqëritë e shërbimeve energjetike janë të detyruara:



a) të punësojnë inxhinierë dhe auditues të energjisë të licencuar dhe të certifikuar, me përvojë në planifikimin, projektimin, zbatimin dhe monitorimin e përmirësimeve të eficiencës së energjisë, si dhe të sigurojnë trajnimin e vazhdueshëm të personelit;

b) të përcaktojnë kushte të qarta dhe të kuptueshme në ofertat e sipas model kontratës së Shtojcës 1;

c) të publikojnë listën e masave të planifikuara për t'u zbatuar dhe kursimet e energjisë që duhet të arrihen sipas përcaktimeve në kontratë;

d) të veprojnë në pajtueshmëri të plotë me zotimet e ndërmarra në bazë të kontratës në lidhje me teknologjinë që do të aplikojnë dhe projektimin, zbatimin, menaxhimin, monitorimin e përmirësimeve të eficiencës së energjisë që kryejnë;

e) të propozojnë masa optimale teknike dhe ekonomike për të përmirësuar eficiencën e energjisë;

f) të paraqesin në mënyrë të qartë, objektive dhe transparente kursimet e energjisë që synohen të arrihen sipas kontratës përkatëse;

g) zbatimi i një pjese ose i të gjitha përmirësimeve të propozuara të eficiencës së energjisë që i nënkontraktohet palëve të treta, t'ia paraqesin konsumatorit fundor detajet e plota, ekspertizën dhe përvojën e çdo pale të tillë të tretë;

h) t'u ofrojnë klientëve udhëzime të sakta dhe të detajuara për operimin dhe mirëmbajtjen e duhur të pajisjeve të instaluar energjetike, si gjatë ashtu edhe pas përfundimit të kontratës;

i) t'i paraqesin klientit në mënyrë të qartë dhe transparente të dhënat financiare, çdo ndryshim çmimi, të përcaktuar në kontratë;

2. Shoqëritë e shërbimeve energjetike, krahas kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, janë të detyruara të ndjekin udhëzimet e përfshira në modelin e kontratës sipas shtojcës 1, e cila duhet të përmbajë minimalisht:

a) kohëzgjatjen dhe fazat e kontratës së performancës energjetike, kushtet e zbatimit të saj dhe periudhën e ndërprerjes;

b) detyrimet e marra përsipër nga secila palë kontraktuese, përfshirë zgjidhjen ndërmjet palëve në rastet e devijimit nga caku i kursimit të energjisë, i cili është vendosur në kontratë;

c) rreziqet të cilat shoqëria e shërbimeve energjetike nuk i merr përsipër;

d) kostot për planifikimin, prokurimin, ndërrimin zëvendësimin, instalimin, operimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve energjetike;

e) koston e përgjithshme të përmirësimeve të eficiencës së energjisë;

f) llojin dhe shumën e financimit;

g) procedurat për matjen dhe verifikimin e kursimeve të arritura të energjisë, përfshirë shpeshhtësinë e raportimit nga shoqëria e shërbimeve të energjisë të klienti;

h) datën referuese për përcaktimin e kursimeve të arritura;

i) metodën dhe kohën e pagesës së shoqërisë së shërbimeve energjetike;

j) procedurat dhe dokumentacioni i të gjitha modifikimeve të bëra gjatë projektit, duke përfshirë ato që lidhen me çfarëdo kushti të ndryshuar që ndikon në përmbajtjen dhe rezultatet e kontratës si ndryshimi i çmimeve të energjisë, ndryshimi i intensitetit të përdorimit të pajisjeve të instaluar energjetike;

k) sanksionet që do të përcaktohen ndaj secilës palë për shkeljen e detyrimeve të tyre përkatëse në përputhje me sesionin e kundërvajtjeve; dhe

l) sigurimin e përgjegjësisë profesionale dhe çdo lloj sigurimi tjetër të rënë dakord sipas kushteve të kontratës së performancës energjetike.

3. Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe për kontratat e shërbimeve të energjisë që lidhen ndërmjet një shoqërie të shërbimeve të energjisë dhe organeve të sektorit publik ose privat që përfshihen në kushtet përkatëse të çfarëdo procedure tenderimi të prokurimit publik të nisur nga organet kompetente.

Neni 8

Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve të energjisë

1. AEE-ja monitoron dhe vlerëson kushtet dhe cilësinë e shërbimeve të energjisë të ofruara nga shoqëritë e shërbimeve energjetike për konsumatorët fundor. Monitorimi dhe vlerësimi i tillë kryhet pas bërjes së një ankese nga një klient.

2. Kompanitë e shërbimeve të energjisë janë të detyruara të:

a) paraqesin në Agjenci, sipas kërkesës, kontratat e shërbimeve të energjisë të lidhura me konsumatorët fundor dhe çdo dokument e të



dhënë tjetër të kërkuar për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara të energjisë;

b) mbajnë shënime të përditësuara për të gjitha kontratat e vlefshme për shërbimet energjetike të lidhura, nga data e nënshkrimit të tyre deri në një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh pas përfundimit të tyre, përfshirë raportet përkatëse, matjet dhe llogaritjet, si dhe shënimet tjera përkatëse, sipas formatit të publikuar nga AEE;

c) t'i sigurojnë AEE-së, sipas kërkesës me shkrim dërgimin e informacionit brenda 7 (shtatë) ditë-pune;

3. Shoqëritë e shërbimeve të energjisë, të cilat janë regjistruar në QKB, duhet të dorëzojnë pranë AEE-së një raport vjetor për vitin paraprak, brenda datës 30 prill të çdo viti, i cili përmban:

a) kopjet e kontratave të shërbimeve të energjisë që i kanë nënshkruar ose zbatuar në vitin e kaluar;

b) një përshkrim të secilës kontratë sipas formatit të publikuar nga Agjencia, duke përfshirë:

c) shërbimet individuale të ofruara të energjisë, teknologjitë e aplikuara dhe aspektet e masave të zbatuara të eficiencës së energjisë si specifikimet teknike të pajisjeve energjetike, kërkesat e operimit dhe mirëmbajtjes, aktivitetet e trajnimit dhe edukimit;

d) detajet e klientit, duke përfshirë sektorin ku operon dhe të dhënat e konsumit të objektit ose ambienteve të konsumatorit fundor;

e) kursimet e vlerësuara dhe të arritura të energjisë sipas çdo kontrate;

f) llojin e financimit për çdo projekt të zbatuar, kohëzgjatja e kontratës;

g) numrin e punonjësve të caktuar për ekzekutimin e çdo kontrate të shërbimeve energjetike.

Neni 10

Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Agjencia për Eficiencën e Energjisë dhe shoqëritë e shërbimeve energjetike për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku

SHTOJCA 1 MODELI I KONTRATËS PËR KONTRAKTIMIN E PERFORMANCËS SË ENERGJISË

PËRMBAJTJA

1. QËLLIMI I KONTRATËS

2. OBJEKTI I KONTRATËS

3. PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PALËVE KONTRAKTUESE DHE DORËZIMI

4. FAZAT E KONTRATËS (PERIUDHAT)

4.1 Kohëzgjatja e kontratës

4.2 Fillimi i periudhës kontraktuale

4.3 Periudhat kryesore të kontratës

5. E drejta për të zgjedhur MKE-të

5.1 Detyrimi për sigurimin e mjeteve financiare për zbatimin e MKE-ve

5.2 Detyrimi për garantimin e një minimumi të kurseveve financiare

5.3 Detyrimi për të bashkëpunuar me klientin në marrjen e lejeve dhe miratimeve të nevojshme

5.4 Përputhshmëria ligjore

5.5 Detyrimi për kryerjen e aktiviteteve

5.5.1 Detyrimet e Kontraktuesit gjatë periudhës përgatitore

5.5.2 Detyrimet e Kontraktuesit gjatë periudhës së zbatimit

5.5.3 Detyrimet e Kontraktuesit gjatë periudhës së garancisë

5.6 Obligimi i transparencës

5.7 E drejta për të shfrytëzuar informacionin e projektit për qëllime komerciale

5.8 E drejta për të transferuar të ardhurat e arkëtueshme

5.9 Angazhimi i nënkontraktuesit

5.10 Detyrimi i Kontraktuesit për të hapur një nënllogar me qëllim të veçantë

5.11 Autorizimi i Kontraktuesit të zotohet për pajisjet e instaluar

6. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KLIENIT

6.1 E drejta për të ndikuar në Projektin e Kontraktuesit

6.2 E drejta e klientit për të audituar nënllogarinë me qëllim të veçantë të Kontraktuesit

6.3 Detyrimi për të mbështetur projektimin dhe zbatimin e MKE-ve

6.3.1 Detyrimet e përgjithshme të klientit



6.3.2 Detyrimet e klientit gjatë periudhës përgatitore

6.3.3 Detyrimet e klientit gjatë periudhës së zbatimit

6.3.4 Detyrimet e klientit gjatë periudhës së garancisë

6.4 Detyrimi për të mbuluar shpenzimet e rehabilitimit për dëmet e paparashikuara gjatë periudhës kontraktuale

7. PROCEDURAT DHE AKTIVITETET

7.1 Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore dhe Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit

7.1.1 Dispozitat e përgjithshme

7.1.2 Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore

7.1.3 Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit

7.2 Incentivat, grantet dhe uljet e çmimit

7.3 Kriteria të rëndësishme për kryerjen e aktiviteteve përgatitore dhe aktiviteteve të zbatimit

7.4 Pengesat për zbatimin e MKE-ve

7.5 Hedhja në mbeturina në mënyrën e duhur e instalimeve me defekt dhe/ose të atyre që janë zëvendësuar

7.6 Procesverbali i auditimit

7.7 Komisionimi i MKE-ve të zbatuara

7.8 Kalimi i së drejtës së pronësisë

7.9 Matja dhe verifikimi

7.10 Mirëmbajtja e MKE-ve

7.11 Rishikimi përfundimtar para përfundimit të periudhës kontraktuale

7.12 Verifikimi përfundimtar i dokumentacionit

8. KUSHTET E GARANCISË

9. PËRCAKTIMI I KURSIMEVE

TË ARRITURA TË ENERGJISË

DHE ATYRE FINANCIARE

DHE KURSIMEVE TË GARANTUARA

9.1 Metodologjia për përcaktimin e kursimeve të arritura të energjisë dhe kursimeve financiare

9.1.1 Parashikimet e përgjithshme

9.1.2 Monedha referencë

9.1.3 Përshtatjet bazë

9.2 Kursimet e garantuara

9.3 Frekuenca e përcaktimit të arritjes së kursimeve të garantuara

9.4 Kursimet financiare shtesë

9.5 Kursimet e garantuara që nuk janë arritur si rezultat i performancës së ulët të Kontraktuesit

9.6 Kursimet e garantuara që nuk janë arritur për shkak të gabimeve të klientit

10. PAGESAT

10.1 Dispozitat e përgjithshme

10.2 Pagesa mujore bazë

10.3 Pagesa shtesë (fakultative)

10.4 Kompensimi në rast të mos arritjes së kursimeve të garantuara (“penalitetet”)

10.5 Kryerja e pagesës

10.6 Afatet e pagesës

11. SIGURIMI I PËRMBUSHJES

SË DETYRIMEVE TË KONTRATËS

11.1 Sigurimi i përmbushjes së detyrimeve të Kontraktuesit

11.1.1 Qëllimi, lloji dhe niveli i sigurisë

11.1.2 Elementet e domosdoshëm të garancisë

11.1.3 Kthimi i garancisë

12. DETYRIMI

12.1 E drejta e klientit për t’u kompensuar për dëmet e shkaktuara nga Kontraktuesi

12.2 E drejta e klientit për t’u kompensuar në rast të dështimit të Kontraktuesit për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në ofertë dhe kontratë

12.3 E drejta e Kontraktuesit për t’u kompensuar për dështimin e klientit për të mbështetur hartimin dhe zbatimin e MKE-ve

13. SIGURIMI

13.1 Pala përgjegjëse

13.2 Dëmi

13.3 Zgjidhja për shkak të dëmit

14. TRANSFERIMI

DHE NËNKONTRAKTIMI

14.1 Miratimi i përbashkët për kompensimin e efekteve të dëmshme

14.2 Kompensimi për Kontraktuesin

15. FORCA MADHORE

16. ZGJIDHJA E KONTRATËS

16.1 Përfundimi dhe zgjidhja e kontratës

16.2 Zgjidhja e kontratës për shkaqe të justifikueshme

16.3 Afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës

16.4 Dëmet si shkak për zgjidhjen e njëanshme të kontratës

17. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

19. KONFIDENCIALITETI

20. KONTRATA



LISTA E SHKURTIMEVE

EE	Eficienca e energjisë
KPE	Kontrata e performancës së energjisë
ESCO	Kompania e Shërbimit Energjetik
LIGJI EE	Ligji i EE nr. 124/2015, datë 12.11.2015, i ndryshuar
Ligji i performancës energjetike në ndërtesa	Ligji i performancës energjetike në ndërtesa nr. 116/2016, datë 10.11.2016
Ligji PP	Ligji mbi prokurimin publik nr. 9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar
M&V	Matja dhe verifikimi
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë
MKE	Masat e kursimit të energjisë

1. QËLLIMI I KONTRATËS

Kontrata ka si qëllim rregullimin e marrëdhënieve juridike midis Kontraktuesit dhe klientit për kryerjen e shërbimeve energjetike të bazuara në kontraktimin e performancës së energjisë nga Kontraktuesi (ESCO), me qëllim arritjen e kursimeve në shpenzimet operative të objektit që do të nënshtrohet shërbimeve, të përdorur nga klienti.

2. OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kontratës aktuale është zbatimi i MKE-ve (masat e kursimit të energjisë) për përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë, reduktimin e emërtimeve të CO₂ dhe reduktimin e kostove operative të ndërtesës së kontraktuar.

Kontraktuesi merr përsipër të zbatojë vetë MKE të tilla, nëpërmjet të cilave do të sigurojë kurse financiare për ndërtesën e kontraktuar gjatë periudhës së garancisë, në përputhje me këtë kontratë (përfshirë të gjitha shtojcat).

Të gjitha MKE-të e zbatuara sipas kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me rregulloret dhe standardet e kërkuara në Republikën e Shqipërisë.

3. PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PALËVE KONTRAKTUESE DHE DORËZIMI

Klienti dhe Kontraktuesi duhet që, brenda tri ditëve nga nënshkrimi i kontratës, të emërojnë përfaqësuesit e tyre të autorizuar, duke dhënë informacionin e plotë mbi kontaktin, në përputhje me listën e paraqitur në shtojcën 2.

Përfaqësuesit e autorizuar të Palëve Kontraktuese duhet të autorizohen për të kryer aktivitete në emër të dhe/ose për llogari të klientit ose Kontraktuesit, d.m.th. të kenë prokurë për të përfaqësuar dhe/ose për të vepruar në emër të klientit ose Kontraktuesit për të gjitha veprimet ligjore dhe operationale që lidhen me kontratën.

4. FAZAT E KONTRATËS (PERIUDHAT)

4.1 Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata e performancës së kursimit të energjisë është lidhur për një periudhë ____ vjet nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kontrata dhe shtojcat e saj hyjnë në fuqi nga data e nënshkrimit të kontratës nga Palët Kontraktuese dhe nëse ato nuk e nënshkruajnë kontratën në të njëjtën datë, atëherë kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Pala Kontraktuese e fundit.

4.2 Fillimi i periudhës kontraktuale

Periudha kontraktuale fillon në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate në përputhje me paragrafin 4.1 të këtij paragrafi.

4.3 periudhat kryesore të kontratës

Kontrata ka tri periudha kryesore: periudhën përgatitore, periudhën e zbatimit dhe periudhën e garancisë.

Periudha përgatitore është periudha e kryerjes së aktiviteteve të planifikimit dhe projektimit që u përkasin aktiviteteve përgatitore të kësaj kontrate. Periudha përgatitore është një periudhë që fillon nga fillimi i periudhës kontraktuale deri në fillimin e periudhës së zbatimit. Palët Kontraktuese do të verifikojnë përfundimin e periudhës përgatitore duke verifikuar Regjistrin e Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore.

Periudha e zbatimit është periudha e kryerjes së aktiviteteve të ndryshme që lidhen me zbatimin e MKE-ve që i përkasin aktiviteteve të zbatimit, siç përcaktohet më poshtë. Periudha e zbatimit është periudha që fillon në datën kur Palët Kontraktuese kanë verifikuar Regjistrin e Aktiviteteve në periudhën përgatitore dhe përfundon kur Palët Kontraktuese kanë verifikuar Regjistrin e Aktiviteteve në periudhën e zbatimit.

Periudha e garancisë është periudha e shfrytëzimit të potencialeve për kursimin e energjisë të kompanisë së kontraktuar, gjatë së cilës kursimet e energjisë, d.m.th. kursimet financiare arrihen për shkak të zbatimit të MKE-ve. Periudha e garancisë fillon në datën kur Palët Kontraktuese verifikojnë Regjistrin e Aktiviteteve në Periudhën e



Zbatimit dhe zgjat deri në fund të periudhës kontraktuale. Në çdo rast, periudha e garancisë nuk do të fillojë pas [data].

5. E drejta për të zgjedhur MKE-të

Kontraktuesi, në përputhje me këtë kontratë, do të vendosë se cilat nga MKE-të do të zbatohen në objektin e kontraktuar të klientit. Si rrjedhim, për sa kohë që Kontraktuesi vepron brenda autorizimit të tij dhe në përputhje me kontratën, klienti nuk mund të refuzojë MKE-të, të cilat janë specifikuar në shtojcën 3 të kontratës, me përjashtim të rasteve kur ai mund t'i referohet mosrespektimit të rregullorëve përkatëse teknike dhe standardeve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, ose formave të tjera të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale.

Në rast se Kontraktuesi, përpara përfundimit të periudhës së zbatimit, arrin në përfundimin se këto ndryshime tek MKE-të:

1) janë objektivisht të nevojshme për realizimin e zbatimit të MKE-ve dhe/ose për përputhshmërinë me rregulloret që mbulojnë shëndetin dhe sigurinë në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen e mjedisit ose për shkak të mospërputhjes midis dokumentacionit teknik përkatës dhe gjendjes aktuale të objektit të kontraktuar, ose për disa arsye të tjera teknike që janë të justifikueshme;

dhe/ose

2) mund të rezultojë në mënyrë më efektive në arritjen e kursimeve financiare, të barabarta ose më të mëdha se kursimet e garantuara.

Kontraktuesi do t'i dorëzojë klientit një kërkesë të justifikuar me shkrim për të marrë miratimin e tij për të vazhduar më tej me ndryshimet e propozuara, kërkesë e cila nuk do të refuzohet nga klienti në mënyrë të paarsyeshme.

Pas marrjes së kërkesës së Kontraktuesit, klienti është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së Kontraktuesit me shkrim brenda 30 ditëve.

Nëse klienti nuk i përgjigjet kërkesës me shkrim të Kontraktuesit brenda afatit prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se e ka miratuar kërkesën e Kontraktuesit.

Nëse ndryshimet përkatëse në MKE-të janë të një natyre të tillë që ato sipas ligjit "Për eficiencën e energjisë" (nr. 124/2015, datë 12.11.2015), i ndryshuar, dhe ligjit PEN nr. 116/2016, datë 10.11.2016 dhe ligjit mbi prokurimin publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar (në rastin kur

klienti përfaqëson një institucion publik), rregulloret respektive të zbatueshme kërkojnë ndryshimin e kësaj kontratë, brenda një periudhe të mëtejshme prej pesë (5) ditësh nga data kur klienti ka miratuar kërkesën e Kontraktuesit, të përmendur në paragrafët 2 dhe 3 të këtij paragrafi, d.m.th. nga data kur klienti konsiderohet se e ka miratuar kërkesën e Kontraktuesit, siç parashikohet në paragrafin 4 të kësaj kontrate, klienti do të fillojë procedurën për marrjen e miratimeve të nevojshme për amendimin e kësaj kontrate në mënyrë që të përfshijë në kontratë ndryshimet përkatëse të MKE-ve, në përputhje me ligjet PP (ligji nr. 9643, datë 20.11.2006), ligji EE (nr. 124/2015), datë 12.11.2015 dhe ligjit PEN (nr. 116/2016) sipas rastit. Brenda së njëjtës periudhë klienti do t'i dorëzojë Kontraktuesit një njoftim me shkrim lidhur me hapat ligjorë të ndërmarra në këtë drejtim.

Brenda një periudhë prej dhjetë ditësh pune nga data kur klienti ka marrë miratimet e nevojshme për të bërë ndryshimin e kësaj kontrate, klienti dhe Kontraktuesi do të bëjnë dhe zbatojnë ndryshimin e kësaj kontrate në mënyrë që të përfshijnë në kontratë ndryshimet përkatëse të MKE-ve, në përputhje me *legjislacionin përkatës* të ligjit PPP (ligji nr. 125/2013) dhe ligji EE (nr. 124/2015, datë 12.11.2015).

Gjatë periudhës që fillon në datën kur Kontraktuesi i ka dorëzuar klientit kërkesën për ndryshime të MKE-ve, në përputhje me paragrafin 3 të këtij paragrafi dhe që përfundon në datën kur ndryshimi përkatës i kontratës është bërë dhe ekzekutuar nga të dyja palët, në përputhje me paragrafët 3-7 të këtij paragrafi, koha për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të Kontraktuesit gjatë periudhës përgatitore dhe/ose periudhës së zbatimit pezullohet.

5.1 Detyrimi për sigurimin e mjeteve financiare për zbatimin e MKE-ve

Kontraktuesi merr përsipër të sigurojë fondet e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e zbatimit të MKE-ve, nga fondet e veta [opsionale dhe/ose huat dhe/ose burime të tjera financiare].

[Opsionale, në rast se klienti merr pjesë në financimin e Projektit:

"Fondet për financimin e shpenzimeve të zbatimit të MKE-ve në ndërtesën e kontraktuar do të sigurohen bashkërisht nga Kontraktuesi dhe klienti.



Kontraktuesi merr përsipër të sigurojë fondet e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e zbatimit të MKE-ve në ndërtesën e kontraktuar gjatë (vendosni periudhat: periudha përgatitore dhe/ose periudha e zbatimit dhe/ose periudha e garancisë) nga kapitali dhe/ose kreditë e veta.

Klienti merr përsipër të sigurojë fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve gjatë (vendosni cilat periudha: periudha përgatitore dhe/ose periudha e zbatimit dhe/ose periudha e garancisë) nga fondet e veta, transferimet dhe/ose donacionet e veta.”

(Në rast se klienti merr pjesë në financimin e Projektit, përveç kësaj, nëse është e nevojshme, lidhja dhe qëllimi i financimit nga Palët Kontraktuese sipas periudhave të veçanta kontraktuale mund të specifikohen më tej.)

5.2 Detyrimi për garantimin e një minimumi të kursimeve financiare

Në varësi të dispozitave të paragrafit 4.1 të kësaj kontrate, Kontraktuesi merr përsipër rrezikun për të arritur kursimet financiare të llogaritura paraprakisht, në bazë të analizës, të cilën ai personalisht e ka kryer në ndërtesën e kontraktuar. Ky detyrim kontraktual përcaktohet më tej në paragrafin 9 të kësaj kontrate.

5.3 Detyrimi për të bashkëpunuar me klientin në marrjen e lejeve dhe miratimeve të nevojshme

Kontraktuesi është i detyruar gjatë gjithë periudhës kontraktuale të marrë të gjitha lejet dhe miratimet e nevojshme për zbatimin e MKE-ve në emër të klientit, në masën e lejuar nga rregulloret e zbatueshme. Në rast se sipas rregullave të zbatueshme nuk lejohet që Kontraktuesi të marrë leje dhe miratime të tilla në emër të klientit, Kontraktuesi do të ofrojë të gjithë ndihmën e arsyeshme për klientin për marrjen e lejeve dhe miratimeve të tilla.

Klienti është i detyruar të bashkëpunojë në procedurën e mësipërme për marrjen e të gjitha lejeve dhe vendimeve të nevojshme për miratimin e aktiviteteve të zbatimit në vijim, si dhe të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që është në posedim të tij ose që është në përputhje me rregulloret teknike dhe rregullore të tjera përkatëse të Republikës së Shqipërisë, në fushën e tij të kompetencës.

5.4 Përputhshmëria ligjore

Kontraktuesi është i detyruar të veprojë në përputhje me ligjin, rregulloret teknike dhe rregullat e tregtisë në Republikën e Shqipërisë, gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij kontraktuale, si

edhe në përputhje me rregullat e kësaj kontrate, përfshirë ato të përcaktuara në paragrafin 7.3 të saj.

Kontraktuesi është i detyruar të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale në një mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme.

5.5 Detyrimi për kryerjen e aktiviteteve

5.5.1 Detyrimet e Kontraktuesit gjatë periudhës përgatitore

Detyrimet e Kontraktuesit në periudhën përgatitore përfshijnë ndër të tjera:

a) informimin e Përfaqësuesit të Autorizuar të klientit për të gjitha MKE-të që janë parashikuar për t'u zbatuar në ndërtesën e kontraktuar, përpara se ato të zbatohen. Kontraktuesi do të shqyrtojë me kujdes të gjitha vërejtjet dhe kërkesat e klientit për ndryshimet dhe ose sugjerimet alternative dhe do të vlerësojë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Nëse Kontraktuesi nuk sheh asnjë përfitim teknik ose financiar të lidhur me këto sugjerime, ai është i detyruar të informojë klientin lidhur me ketë konkluzion dhe do të lejohet të zbatojë MKE-të specifike, siç janë planifikuar në ofertë e tij dhe si më poshtë;

b) sipas nevojës, përgatitjen dhe ekzekutimin dhe/ose nxjerrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm teknik të kërkuar për nxjerrjen e lejeve të kërkuara, sipas rregullave të zbatueshme, dhe kryerjen e aktiviteteve përkatëse të lidhura me të;

c) prokurimin e materialeve dhe pajisjeve në rastin e institucioneve publike;

d) mbajtjen e rregullt të Regjistrit të Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore, në përputhje me paragrafin 7.1.2 të kësaj kontrate;

e) kryerjen e aktiviteteve të nevojshme për nxjerrjen e lejes përfundimtare dhe detyruesë të ndërtimit nga ana e klientit ose lejeve të tjera të nevojshme për fillimin e aktiviteteve të zbatimit, sipas rregulloreve të zbatueshme, dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera përgatitore.

5.5.2 Detyrimet e Kontraktuesit gjatë periudhës së zbatimit

Detyrimet e Kontraktuesit në periudhën e zbatimit përfshijnë ndër të tjera:

a) kryerjen e punimeve të ndërtimit, montimin e instalimeve, pjesëve të tyre, pajisjeve ose aparateve;

b) planifikimin dhe koordinimin e aktiviteteve të zbatimit me përfaqësuesin e autorizuar të klientit për të zvogëluar ndërprerjen e funksionimit të rregullt të ndërtesës së kontraktuar deri në masën e zbatueshme;



c) përcaktimin e procedurave operacionale dhe të mirëmbajtjes;

d) identifikimin e aktiviteteve specifike të menaxhimit të energjisë;

e) informimin në kohë të klientit sapo Kontraktuesi të vihet në dijeni të çështjeve që mund të ndikojnë materialisht në funksionimin e sigurt ose eficient të ndërtesës së kontraktuar;

f) aty ku është e aplikueshme, sigurimin e garancive standarde nga nënkontraktuesit, prodhuesit e pajisjeve dhe materialeve për cilësinë dhe funksionimin e duhur;

g) marrjen e pajisjeve dhe materialeve në ndërtesën e kontraktuar;

h) mbajtjen e rregullt të regjistrit të planeve të ndërtimit, ditarit të ndërtimit dhe regjistrave të tjera të kërkuara sipas rregullave të zbatueshme;

i) mbajtjen e rregullt të Regjistrit të Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit, në përputhje me paragrafin 7.1.3 të kësaj kontrate;

j) asgjësimin e instalimeve të dëmtuara dhe/ose të zëvendësuara, pjesëve të tyre dhe pajisjeve të MKE-ve, në intervale të rregullta;

k) komisionimin e punëve të kryera, pajisjeve të instaluara, instalimeve dhe/ose pjesëve të instalimeve, siç/nëse kërkohet sipas rregullave të zbatueshme;

l) kryerjen e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për nxjerrjen e lejes përfundimtare dhe të detyrueshme të përdorimit nga ana e klientit, nëse kërkohet sipas rregulloreve të zbatueshme, dhe detyrimet e tjera të nevojshme për aktivitetet e zbatimit.

5.5.3 Detyrimet e Kontraktuesit gjatë periudhës së garancisë

Detyrimet e Kontraktuesit gjatë periudhës së garancisë përfshijnë ndër të tjera:

a) kryerjen e të gjithë aktiviteteve të nevojshme M&V dhe përgatitjen e raporteve M&V sipas Planit M&V për të paraqitur kursimet e gjeneruara të energjisë dhe kursimet financiare për çdo periudhë tremujore;

b) mirëmbajtjen e pajisjes dhe sistemit të instaluar si pjesë e MKE-ve;

5.6 Obligimi i transparencës

Kontraktuesi ka obligimin e transparencës në lidhje me të gjitha MKE-të që do të zbatohen gjatë gjithë periudhës kontraktuale. Në mënyrë më specifike, Kontraktuesi duhet të mbajë rregullisht Regjistrin e Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore

dhe Regjistrin e Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit, në përputhje me këtë kontratë, si dhe për të mbajtur klientin të informuar në çdo kohë rreth projektimit të pajisjes, të sistemit dhe instalimin për fazat në vijim:

1) faza e planifikimit dhe projektimit gjatë periudhës përgatitore;

2) procesi i furnizimit me pajisje gjatë periudhës përgatitore;

3) aktivitetet e zbatimit, Komisionimi etj., gjatë periudhës të zbatimit.

Klienti ka të drejtë që të procedojë me rishikimin e të gjitha marrëveshjeve kontraktuale dhe shpenzimeve të Kontraktuesit që lindin si rezultat i kësaj kontrate.

5.7 E drejta për të shfrytëzuar informacionin e projektit për qëllime komerciale

Kontraktuesi është i autorizuar, në përputhje me rregulloret që i referohen klientit, që të zbulojë lirisht elementet përkatëse të Projektit të trajtuara nga kontrata, si projekt referencë, dhe të përdorë fotografitë e objektit të kontraktuar dhe/ose shërbimet dhe punët e kryera prej tij në objektin e kontratuar për atë qëllim, me miratimin paraprak të klientit, të gjitha me qëllim për të mbrojtur të drejtat e klientit.

5.8 E drejta për të transferuar të ardhurat e arkëtueshme

Kontraktuesi ka të drejtë të caktojë, pa ndonjë pëlqim të mëtejshëm të klientit, një të drejtë për një pjesë ose gjithë kompensimin ose çdo shumë tjetër që paguhet nga klienti në bazë të kësaj kontrate të performancës së kursimit të energjisë një institucioni ose organi financiar, i cili ofron mbështetje kredie për Kontraktuesin dhe klienti e pranon plotësisht këtë aktim.

Në këtë rast, klienti do të paguajë këtë pjesë të kompensimit ose të gjithë kompensimin, ose çdo shumë tjetër të paguar nga klienti te Kontraktuesi në përputhje me këtë kontratë të performancës së kursimit të energjisë, direkt tek institucioni financiar ose organi, i cili ofron mbështetje kredie te Kontraktuesi.

[Opsionale, në rastin kur financimi është dhënë dhe menaxhuar nga klienti: një institucion apo organ i tillë financiar do të ketë të drejtë të kërkojë pagesën e kompensimit ose shumave të tjera që paguhet nga klienti këtu, drejtpërdrejt nga klienti menjëherë pasi kërkesa përkatëse të bëhet e detyrueshme dhe e pagueshme, pavarësisht nëse Kontraktuesi ka lëshuar një faturë në përputhje me



paragrafin 10.6. Në lidhje me kërkesat e caktuara siç përcaktohet këtu, klienti pajtohet që institucioni ose organi i tillë financiar të ketë të drejtë, por jo të jetë i detyruar, të ushtrojë ndonjë të drejtë të Kontraktuesi dhe/ose të përmbushë ose shkaktojë përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tij në bazë të kësaj kontrate të performancës së kursimit të energjisë.]

Me lidhjen e kësaj kontrate, klienti jep pëlqimin e tij që Kontraktuesi të autorizohet të transferojë të ardhurat e arkëtueshme nga pagesa bazë, të përmendur në paragrafin 10.2 të kësaj kontrate, te financieri/banka në përputhje me ligjet e zbatueshme të Republikës së Shqipërisë.

Klienti nuk ka të drejtë rekursi kundrejt përfituesit (financieri/banka).

Nëse kursimet e garantuara nuk materializohen, klienti ka të drejtë rekursi kundrejt Kontraktuesit nëpërmjet, por pa u kufizuar, kompensimit/gjobave për kursimet e garantuara të paarritura.

5.9 Angazhimi i nënkontraktuesit

Kontraktuesi, në përputhje me ofertën, do të angazhojë ____ [të vendoset emri dhe selia e regjistruar e nënkontraktuesit] si nënkontraktues, përzgjedhja e të cilit miratohet nga klienti.

[Në mënyrë alternative me paragrafin e mësipërm, mund të përcaktohet si vijon: “Kontraktuesi është i autorizuar të angazhojë një nënkontraktues, me kusht që ky nënkontraktues të jetë miratuar më parë nga klienti me shkrim brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të klientit nga ana e Kontraktuesit, miratimi i cili nuk duhet të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme dhe do të bazohet në përputhshmërinë me kërkesat ligjore të zbatueshme.

Kontraktuesi është përgjegjës kundrejt klientit për aktivitetet ose dështimet e nënkontraktuesit, sipas paragrafit 1 të këtij paragrafi, njësoj sikur ai t'i kishte kryer vetë ato.

Gjatë periudhës kontraktuale, Kontraktuesi mund të punësojë nënkontraktues të tjerë nëse nënkontraktuesi është bërë i paaftë të paguajë për një periudhë të gjatë kohore ose për shkaqe të tjera thelbësore, me kusht që entiteti i ri të përmbushë të gjitha kërkesat e përcaktuara për një nënkontraktues dhe me kusht që Kontraktuesi të marrë miratimin paraprak të klientit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të klientit nga ana e Kontraktuesit, miratimi i cili nuk do të refuzohet

ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme dhe do të bazohet në përputhshmërinë me kërkesat ligjore të zbatueshme.

Klienti do të refuzojë miratimin e tij për përfshirjen e nënkontraktuesit, nëse ka arsye të justifikueshme për ta bërë këtë gjë.

5.10 Detyrimi i Kontraktuesit për të hapur një nënlllogari me qëllim të veçantë

Në datën e lidhjes së kësaj kontrate, Kontraktuesi është i detyruar të ketë një nënlllogari me qëllim të veçantë në bankën tregtare, me të cilën ai bën shumicën e veprimeve të tij. Nënlllogaria do të jetë llogaria e përdorur nga Kontraktuesi për të gjitha pagesat hyrëse dhe dalëse që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij sipas kësaj kontrate.

5.11 Autorizimi i Kontraktuesit të zotohet për pajisjet e instaluar

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, klienti jep pëlqimin e tij që Kontraktori të jetë i autorizuar t'i zotohet pajisjes së instaluar ndaj financierit / bankës, në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

6. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KLIENIT

6.1 E drejta për të ndikuar në Projektin e Kontraktuesit

Pavarësisht paragrafit 5.1 të kontratës, Kontraktuesi detyrohet të ndalojë zbatimin e MKE-ve të synuara prej tij, pas njoftimit me shkrim nga klienti në rastet e mëposhtme:

1) nëse Kontraktuesi, pavarësisht kërkesës së klientit për të vepruar kështu, nuk demonstroi që MKE-të mund të arrijnë standardet e kërkuara dhe rregulloret e zbatueshme;

2) nëse Kontraktuesi nuk vepron në përputhje me kriteret e transparencës sipas paragrafit 5.7 të kontratës në lidhje me MKE-të.

Në rast se Kontraktuesi dhe klienti nuk bien dakord pas demonstrimit të kontraktuesit që MKE-të janë në përputhje me standardet dhe rregullat e zbatueshme, çështja do të zgjidhet në përputhje me paragrafin 17.1 të kësaj kontrate.

6.2 E drejta e klientit për të audituar nënlllogarinë me qëllim të veçantë të Kontraktuesit

Klienti ka të drejtën, gjatë gjithë periudhës kontraktuale, të kontrollojë dhe auditojë nënlllogarinë e Kontraktuesit me qëllim të veçantë, e referuar në nenet 5.7 dhe 5.11 të kësaj kontrate, në



përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë (këtu duhet të vendoset ligji që rregullon këtë kontratë).

6.3 Detyrimi për të mbështetur projektimin dhe zbatimin e MKE-ve

6.3.1 Detyrimet e përgjithshme të klientit

Klienti është i detyruar të:

1. bashkëpunojë me Kontraktuesin në përpjekjet e tij për të zbatuar dhe financuar MKE-të në ndërtesën e kontraktuar dhe të arrijë kursimet e garantuara, siç paraqiten në ofertën e kontraktuesit dhe në këtë kontratë, dhe

2. përmbushë detyrimet e tij kontraktuale të përcaktuara më poshtë në mënyrë që të kontribuojë në zvogëlimin e shpenzimeve të zbatimit dhe atyre operative, që janë në ngarkim të Kontraktuesit gjatë periudhës kontraktuale. Për ta realizuar këtë, klienti pranon të bashkëpunojë plotësisht me Kontraktuesin gjatë gjithë fazave të Projektit të parashikuara më poshtë.

6.3.2 Detyrimet e klientit gjatë periudhës përgatitore

Detyrimet e klientit gjatë periudhës përgatitore përfshijnë ndër të tjera:

1. deri në nivelin e disponueshëm, klienti do t'i sigurojë në kohë të gjithë informacionin Kontraktuesit për të kryer aktivitetet e tij, që përfshijnë, por nuk është e kufizuar në sigurimin e:

- dokumentacionit teknik ekzistues në lidhje me objektin e kontraktuar, si dhe informacionit mbi operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve në objektin e kontraktuar;

- regjistrimeve dhe të dhënave mbi përdorimin e energjisë në kompaninë e kontraktuar dhe informacionit tjetër përkatës (nëse nuk janë të disponueshme, klienti do t'u kërkojë furnizuesve të energjisë për t'i siguruar ato);

- çdo kërkesë të vendosur nga rregulloret dhe/ose kërkesat (teknike) të ndërtimit, kufizimet që lidhen në mënyrë specifike me objektin e kontraktuar që ndryshojnë nga ato që zbatohen në përgjithësi për ndërtimin;

- të gjithë informacionin tjetër dhe/ose dokumentet e kërkuara në mënyrë të arsyeshme.

2. Klienti do të rishikojë, dhe më pas miratojë ose refuzojë me shkrim për shkaqe të arsyeshme (të tilla si p.sh. mospërputhje me rregulloret e zbatueshme dhe standardet e kërkuara, pamundësia për të zbatuar MKE-të për shkak të ndryshimeve të

papritura në objektin e kontraktuar, pamundësia për të zbatuar MKE-të në kushte normale që nuk mund të ndryshohen etj.), dokumentacionin teknik të përgatitur nga Kontraktuesi përpara miratimit zyrtar të dokumentacionit teknik në përputhje me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë planifikimin dhe ndërtimin, brenda 14 ditëve nga data e dorëzimit të dokumentacionit teknik prej Kontraktuesit te përfaqësuesi i autorizuar i klientit. Në rast mosmarrëveshjeje midis klientit dhe Kontraktuesit për shkak të refuzimit nga ana e klientit, çështja do të zgjidhet në përputhje me paragrafin 17 të kësaj kontrate;

3. Në varësi të përmbushjes së vlefshme të të gjitha aktiviteteve përgatitore nga ana e Kontraktuesit, siç përcaktohet më poshtë, dhe marrjes së lejes përfundimtare dhe detyruese të ndërtimit ose lejeve të tjera që lejojnë fillimin e aktiviteteve të zbatimit, nëse kërkohet sipas rregulloreve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, klienti do të miratojë Regjistrin e Aktiviteteve të Kontraktuesit për Periudhën Përgatitore.

6.3.3 Detyrimet e klientit gjatë periudhës së zbatimit

Detyrimet e klientit gjatë periudhës së zbatimit përfshijnë ndër të tjera:

1. lejinin e dorëzimit të pajisjeve dhe materialeve në objektin e kontraktuar;

2. sigurimin e aksesit të pakufizuar në objektin e kontraktuar për Kontraktuesin dhe personelin ose Nënkontraktuesit e tij, për të kryer çdo funksion që lidhet me këtë kontratë, gjatë orëve të rregullta të punës, ose orëve të tjera të tilla, siç mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Kontraktuesi, duke mos ndikuar negativisht në operimin ndërtesës së kontraktuar;

3. informimin në kohë të Kontraktuesit sapa klienti të vihet në dijeni të çështjeve që mund të ndikojnë materialisht detyrimet e Kontraktuesit ose të klientit sipas kësaj kontrate, ose ndikojnë në sigurinë e operimit eficient të Projektit ose ndërtesës së kontraktuar;

4. rishikimin dhe miratimin ose refuzimin me shkrim për shkaqe të arsyeshme, të dokumentacionit teknik përkatës, brenda 14 ditëve nga data e dorëzimit prej Kontraktuesit te përfaqësuesi i autorizuar i klientit. Në rast mosmarrëveshjeje midis klientit dhe Kontraktuesit për shkak të refuzimit të klientit, çështja do të



zgjidhet në përputhje me paragrafin 17 të kësaj kontrate;

5. pranimin e shqetësimeve të arsyeshme e të përkohshme për zbatimin dhe komisionimin e punëve dhe lejin/lehtësimin e kryerjes së punëve nga ana e Kontraktuesit sipas grafikut kohor të ndërtimit të rënë dakord;

6. marrjen pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e komisionimit të Kontraktuesit;

7. sigurimin e hapësirës së mjaftueshme dhe të përshtatshme, pa pagesë, nëse është e disponueshme, për ruajtjen e materialeve në ndërtesën e kontraktuar;

8. në varësi të përmbushjes së vlefshme të të gjitha aktiviteteve të zbatimit nga ana e Kontraktuesit, siç përcaktohet më poshtë, dhe marrjes së lejes përfundimtare dhe detyruese të shfrytëzimit, nëse kërkohet sipas rregulloreve të zbatueshme, klienti do të miratojë Regjistrin e Aktiviteteve të Kontraktuesit për Periudhën e Zbatimit.

6.3.4 Detyrimet e klientit gjatë periudhës së garancisë

Detyrimet e klientit gjatë periudhës së garancisë përfshijnë ndër të tjera dhe:

1. informimin e Kontraktorit për çdo ndryshim të konsumit sipas skenarit bazës të objektit të kontraktuar që mund të kërkojë rregullime jorutinë, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pas ndryshimeve të ndodhura;

2. sigurimin që ndërtesa e kontraktuar është përdorur në mënyrën e duhur dhe mirëmbajtur në përputhje me mënyrën e përcaktuar së bashku si nga klienti ashtu edhe nga Kontraktuesi;

3. informimin e Kontraktuesit për çdo prishje ose keqfunksionim të MKE-ve sa më shpejt që informacion i tillë të bëhet i disponueshëm;

4. sigurimin që çdo përshtatje pasuese tek instalimet, pjesët e tyre dhe pajisjet përkatëse për konsumin e energjisë dhe të kryera nga klienti do të regjistrohen me kujdes dhe Kontraktuesi do të informohet pa vonesë;

5. mbrojtjen e ndërtesës së kontraktuar nga dëmtimi i qëllimshëm fizik;

6. paraqitjen ose lejinin e Kontraktuesit për të aksesuar të dhënat e nevojshme për përgatitjen e raporteve të M&V, bazuar në planin e miratuar të M&V;

7. shqyrtimin dhe miratimin e raporteve të M&V, të hartuara në bazë të Planit të M&V, për

përcaktimin dhe pagimin e pagesave shtesë ose gjobave;

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmeve që rezultojnë nga fakti që klienti nuk respekton detyrimet e tij sipas këtij paragrafi.

6.4 Detyrimi për të mbuluar shpenzimet e rehabilitimit për dëmet e paparashikuara gjatë periudhës kontraktuale

Në rast se dëmet e paparashikuara, jo të shkaktuara nga aktivitetet e Kontraktuesit, ndodhin në objektin e kontraktuar gjatë periudhës kontraktuale dhe rehabilitimi (riparimi ose zëvendësimi) i tyre është i nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, klienti është i detyruar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për rehabilitimin, në periudhën kohore më të shkurtër të arsyeshme, dhe të mbulojë shpenzimet e rehabilitimit, periudhë gjatë së cilës përmbushja e detyrimeve kontraktuale të Kontraktuesit do të pezullohet.

Pavarësisht dispozitës së paragrafit 1 të këtij paragrafi, Kontraktuesi, pas një kërkesë të qartë të klientit dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm që rregullon _____ (*këtu duhet të vendoset ligji që rregullon Kontratën*) dhe rregulloret e tjera, mund të lidhë dhe ekzekutojë amendimin e kësaj kontrate në mënyrë që të rregullojë performancën e Kontraktuesit për çdo punë të tillë në lidhje me riparimin e dëmeve të paparashikuara të referuara në paragrafin 1 të këtij paragrafi, rregullat e së cilës që janë përcaktuar në paragrafin 5.1, paragrafët 5, 6 dhe 7 të kësaj kontrate do të zbatohen *mutatis mutandi*.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmeve që rezultojnë nga fakti që klienti nuk ka respektuar detyrimet e tij sipas këtij paragrafi.

7. PROCEDURAT DHE AKTIVITETET

7.1 Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore dhe Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit

7.1.1 Dispozitat e përgjithshme

Kontraktuesi është i detyruar të mbajë regjistrat e aktiviteteve gjatë periudhës përgatitore dhe periudhës së zbatimit.

Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore dhe në Periudhën e Zbatimit duhet të jetë i aksesueshëm për klientin dhe Palën Kontraktuese përgjatë gjithë periudhës kontraktuale.



Kryerja e aktiviteteve përgatitore në periudhën përgatitore dhe e aktiviteteve të zbatimit në periudhën e zbatimit nga Kontraktuesi konfirmohet nga verifikimi i Regjistrit të Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore dhe i Regjistrit të Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit nga klienti.

Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore mund të verifikohet nga nënshkrimi i Palëve Kontraktuese vetëm pasi të gjitha Aktivitetet Përgatitore të parashikuara në këtë kontratë të jenë kryer nga Kontraktuesi d.m.th. Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit mund të verifikohet nga nënshkrimi i Palëve Kontraktuese vetëm pasi të gjitha aktivitetet e zbatimit të parashikuara në këtë kontratë të jenë kryer nga Kontraktuesi.

Për të shmangur dyshimet, verifikimi i Regjistrit të Aktiviteteve në Periudhën Përgatitore nuk do të ndodhë përpara se leja e ndërtimit ose ndonjë leje tjetër e nevojshme për fillimin e punëve ndërtimore, nëse kërkohet sipas rregulloreve të zbatueshme, të merret sipas rregullit dhe të bëhet përfundimtare dhe e detyrueshme, d.m.th. verifikimi i Regjistrit të Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit nuk do të ndodhë përpara marrjes së leja e shfrytëzimit, nëse kërkohet nga rregulloret e zbatueshme, të marrë formë përfundimtare dhe të detyrueshme.

7.1.2 Regjistri i aktiviteteve në periudhën përgatitore

Regjistri i aktiviteteve të kontraktuesit në periudhën përgatitore do të pasqyrojë të gjitha aktivitetet përgatitore të Kontraktuesit, dhe veçanërisht ato që lidhen me:

1. Planifikimin e kohës, marrjen e licencave, miratimet, opinionet dhe/ose përpunimin e dokumentacionit teknik dhe shqyrtimin e tij teknik në rastin e entiteteve publike.

2. Marrjen e lejes përfundimtare dhe detyruese të ndërtimit dhe/ose lejeve të tjera që mundësojnë fillimin e aktiviteteve të zbatimit, nëse leje të tilla kërkohen në rastin specifik sipas rregulloreve të zbatueshme.

7.1.3 Regjistri i aktiviteteve në periudhën e zbatimit

Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit do të pasqyrojë të gjitha aktivitetet e Kontraktuesit që përfaqësojnë aktivitetet e zbatimit të mëposhtme, dhe veçanërisht ato që u referohen:

- 1) punëve ndërtimore, montimit të instalimeve, pjesëve të tyre, ose pajisjeve në objektin e kontraktuar, mirëmbajtjes dhe zëvendësimit të instalimeve, pjesëve të tyre, ose pajisjeve në objektin e kontraktuar, hedhjes dhe asgjësimit në mënyrën e duhur në mbeturina të instalimeve të prishura dhe/ose të zëvendësuar, pjesëve të tyre dhe pajisjeve, mbikëqyrjes së punimeve nga ekspertë, inspektimit teknik të punëve;

- 2) të gjitha aktiviteteve të lidhura me zbatimin e Planit të M&V;

- 3) komisionimit të punëve të kryera, pajisjeve të instaluar dhe/ose pjesëve të instalimeve, siç/nëse kërkohet nga rregulloret e zbatueshme;

- 7) pranimit teknik të punëve dhe veprimeve të nevojshme për marrjen e lejes përfundimtare dhe të detyrueshme të shfrytëzimit nga ana e klientit, nëse kërkohet nga rregulloret e zbatueshme, dhe detyrime të tjera të kërkuara për aktivitetet e zbatimit.

7.2 Incentivat, grantet dhe uljet e çmimit

Palët Kontraktuese janë të detyruara të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në mënyrë që të aplikojnë për ndonjë grant, incentive apo ulje çmimi. Kontraktuesi do të aplikojë, ose do ta asistojë klientin gjatë aplikimit për ndonjë incentivë, financim, rimbursim, ulje çmimi dhe kthim parash për të cilat MKE-të janë të pranueshme dhe reduktojnë kostot e investimit të përcaktuara në kontratë.

7.3 Kriteria të rëndësishme për kryerjen e aktiviteteve përgatitore dhe aktiviteteve të zbatimit

Aktivitetet përgatitore dhe aktivitetet e zbatimit të Kontraktuesit konsiderohen të përfunduara, sipas Kontratës, vetëm nëse janë në përputhje me kriteret e cilësisë të specifikuar në kontratë, të cilat do të konfirmohen nga nënshkrimi i klientit në Regjistrin e Aktiviteteve për periudhën përgatitore, d.m.th. në Regjistrin e Aktiviteteve në periudhën e zbatimit.

Aktivitetet përgatitore dhe aktivitetet e zbatimit duhet të përputhen veçanërisht me kriteret e mëposhtme:

1. këto aktivitete duhet të kryhen në përputhje me ligjin, rregulloret teknike dhe rregulloret e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe për to duhet të merren licencat, miratimet dhe lejet përkatëse, si dhe mbikëqyrja profesionale e punëve, inspektimi teknik dhe pranimi i punëve dhe, nëse kërkohet,



marrja e lejeve përkatëse, përfundimtare dhe të detyrueshme, për ndërtimin, shfrytëzimin, si dhe leje të tjera të nevojshme për ndërtimin e përshtatshëm dhe shfrytëzimin e duhur të objektit të kontraktuar;

2. përputhje funksionale me instalimet dhe komponentët ekzistues në ndërtesën e kontraktuar;

3. respektimi i rregulloreve të zbatueshme dhe standardeve të kërkuara të komfortit, si dhe standardeve të tjera të përshtatshme për ndërtesën specifike të kontraktuar;

4. përputhje strukturore me strukturën e investimit të përcaktuar në ofertën e Kontraktuesit;

5. kryerja e aktiviteteve teknike në mënyrë të tillë që përdoruesit e objektit të Kontraktuar të mos kufizohen në përdorimin e objektit më shumë sesa është e nevojshme.

7.4 Pengesat për zbatimin e MKE-ve

Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të identifikuar pengesat për zbatimin e MKE-ve dhe për të ofruar propozimin për t'i kapërcyer ato kur është e mundur. Kontraktuesi nuk mund të mbajë përgjegjësi për ndonjë pengesë që nuk mund të identifikohet objektivisht gjatë Periudhës Përgatitore, edhe me zbatimin e nivelit të kërkuar të kujdesit nga ana e Kontraktuesit.

7.5 Hedhja në mbeturina në mënyrën e duhur e instalimeve me defekt dhe/ose të atyre që janë zëvendësuar

Kontraktuesi kryen me shpenzimet e veta hedhjen në vendgrumbullimin e mbeturinave të instalimeve, pjesëve të tyre ose pajisjeve dhe materialeve të çdo lloji, të cilat janë defekte/ose me të meta ose janë zëvendësuar gjatë periudhës së zbatimit dhe/ose gjatë mirëmbajtjes së MKE-ve të zbatuara në objektin e kontraktuar, në përputhje me rregulloret e zbatueshme mbi asgjësimin e mbeturinave bashkiake, mbetjeve të rrezikshme dhe llojeve të tjera, me përjashtim të rasteve kur klienti dëshiron t'i përdorë ato për qëllime të tjera.

Në rast se klienti dëshiron të shesë pajisjen ose materialin, përfitimet nga ky transaksion do të mbahen tërësisht nga klienti.

Në rast se klienti dëshiron të ripërdorë pajisjen ose materialin në ndonjë objekt tjetër që nuk përfshihet në këtë kontratë, për Kontraktuesin nuk do të ketë ndonjë kompensim.

7.6 Procesverbali i auditimit

Menjëherë pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve të zbatimit, me përjashtim të

komisionimit dhe përpara komisionimit, në pajtim me paragrafin 7.8 të kësaj kontrate, Palët Kontraktuese do të kryejnë auditime të përbashkëta të të gjitha MKE-ve të zbatuara nga Kontraktuesi sipas kësaj kontrate, në mënyrë që të konfirmojnë gatishmërinë e tyre për komisionim dhe ata do të përgatisin dhe do të nënshkruajnë procesverbalin e auditimit ("Procesverbali i auditimit"), si provë për auditimin e kryer.

Nëse pas zbatimit të MKE-ve nuk plotësohen kushtet për komisionim, Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë kushtet e duhura me shpenzimet e veta, duke riparuar të gjitha mangësitë dhe defektet brenda një muaji nga data e kryerjes së auditimit të referuar në paragrafin 1 të këtij paragrafi.

Në rast se Kontraktuesi dështon në kryerjen e aktiviteteve të paragrafit 2 të këtij paragrafi, brenda kohës së specifikuar, aktivitetet në fjalë do të organizohen nga klienti, dhe në këtë rast Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për t'i kompensuar klientit vlerën e MKE-ve që nuk janë zbatuar për periudhën derisa mangësitë dhe defektet përkatëse të jenë riparuar, por jo më gjatë se gjashtë muaj, si dhe për të kompensuar klientin për të gjitha dëmet e pësuar.

Klienti nuk mund të kushtëzojë ndonjë pretendim ekzistues të Kontraktuesit duke kërkuar riparimin e të gjitha mangësive dhe defekteve të MKE-ve.

Në çdo rast, detyrimi i Kontraktuesit për të kompensuar klientin sipas këtij paragrafi, nuk duhet të kalojë shumën e dëmit aktual që i shkaktohet klientit.

7.7 Komisionimi i MKE-ve të zbatuara

Klienti do të lejojë fillimin e komisionimit të MKE-ve vetëm pas përfundimit të tyre dhe eliminimit të të gjitha të metave dhe defekteve.

Për shmangien e çdo dyshimi, periudha e garancisë nuk mund të fillojë derisa:

1. Të ketë përfunduar në kohë komisionimi,

2. Të gjitha mangësitë dhe defektet nga zbatimi i MKE-ve të përcaktuara gjatë komisionimit të jenë eliminuar (nëse ka ndonjë),

3. Leja e përdorimit, nëse kërkohet nga rregulloret e zbatueshme, të jetë marrë dhe të jetë bërë finale dhe e detyrueshme, dhe

4. Palët Kontraktuese të kenë verifikuar Regjistrin e Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit.



7.8 Kalimi i së drejtës së pronësisë

E drejta e pronësisë së instalimeve, pjesëve të tyre, ose pajisjeve, që Kontraktuesi do të instalojë ose do të përfshijë në ndonjë mënyrë tjetër në objektin e kontraktuar, gjatë zbatimit të kontratës, kalon te klienti pas fundit të periudhës të kontratës, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në rregulloret e zbatueshme.

E drejta e pronësisë së instalimeve, pjesëve të tyre, ose pajisjeve që Kontraktuesi do të instalojë ose do të përfshijë në ndonjë mënyrë tjetër në objektin e kontraktuar, gjatë zbatimit të MKE-ve, kalon te klienti pas verifikimit të Regjistrimit të Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit nga Palët Kontraktuese dhe fillimit të periudhës së garancisë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në rregulloret e zbatueshme.

Në rast se në periudhën e garancisë, Kontraktuesi detyrohet të instalojë pajisje, instalime, ose pjesë të tyre me shpenzimet e veta, e drejta e pronësisë mbi këto MKE do të kalojë te klienti pas verifikimit të këtyre aktiviteteve (me anë të nënshkrimeve) nga Palët Kontraktuese, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në rregulloret e zbatueshme.

7.9 Matja dhe verifikimi

Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha aktivitetet e M&V bazuar në Planin e M&V që do të jetë pjesë e ofertës së Kontraktuesit. Planin e M&V mund të përshtatet gjatë periudhës përgatitore dhe periudhës të zbatimit bazuar në marrëveshjen e përbashkët të palëve.

Ndërsa kryen aktivitetet e M&V, Kontraktuesi do të duhet të respektojë parimet e mëtejshme thelbësore të praktikës në të mirën e M&V, në veçanti:

1. Raportet M&V duhet të jenë të sakta siç përcaktohet në Planin M&V;

2. Raportimi mbi kursimet e energjisë dhe ato financiare duhet të marrë në konsideratë të gjitha efektet e Projektit.

3. Kur bëhen vlerësime për sasinë e papërcaktuara, procedurat M&V duhet të hartohen në mënyrë të tillë në mënyrë që të vlerësohen si kursimet e energjisë ashtu edhe kursimet financiare.

4. Raportimi i efektivitetit të Projektit duhet të jetë në përputhje ndërmjet:

- llojeve të ndryshme të MKE-ve;

- periudhave të ndryshme të kohës për të njëjtin Projekt;

5. Përcaktimi i kursimeve të energjisë dhe kursimeve financiare duhet të pasqyrojnë parametrat e performancës së matjes, ndërsa parametra të tjerë më pak kritikë ose të parashikueshëm mund të vlerësohen.

6. Të gjitha aktivitetet M&V duhet të përhapen dhe dokumentohen qartësisht dhe plotësisht.

Raportet M&V duhet të përgatiten nga Kontraktuesi çdo tre muaj gjatë periudhës së garancisë. Ato do të duhet t'i dërgohen klientit jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të periudhës tremujore që mbulon raportin. Procedurat e mëposhtme të miratimit do të mbikëqyren:

- raportin duhet të miratohet nga klienti jo më vonë se 15 ditë pas marrjes të tij;

- nëse klienti kundërshton përfundimin e raportit, ai duhet të njoftojë Kontraktuesin brenda periudhës prej 15 ditësh nga marrja e raportit. Klienti do t'i paraqesë Kontraktuesit arsyet e kundërshtimeve të tij;

- Kontraktuesi duhet që, brenda periudhës prej 15 ditësh, nga marrja e kundërshtimeve të klientit, të bëjë korrigjimet e nevojshme dhe t'i dërgojë raportin përsëri klientit.

Nëse klienti nuk bie dakord me përfundimet e raportit të M&V, të dyja palët do të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre në përputhje me paragrafin 17.1 të kësaj kontrate.

7.10 Mirëmbajtja e MKE-ve

Kontraktuesi garanton kryerjen e mirë të punëve dhe funksionimin e duhur të pjesëve në vijim (instalimet, pjesët e tyre dhe pajisjet e instaluar), siç përcaktohet në paragrafin 8 të kësaj kontrate. Për sigurimin e gjendjes operationale të ndërtesës së kontraktuar me qëllim arritjen e kursimeve, gjatë periudhës kontraktuale, Kontraktuesi merr përsipër të mirëmbajë MKE-të e instaluar në ndërtesën e kontraktuar në përputhje me rregulloret dhe standardet përkatëse dhe në përputhje me projektin e instalimit dhe mirëmbajtjes së objektit, që do të jenë një pjesë e pandarë e dokumentacionit të projektit dhe që nuk do të kufizojë konkurrencën në prokurimin e pjesëve të këmbimit për MKE-të, që është zëvendësimi i MKE-ve.

Kontraktuesi është i detyruar të zbatojë të gjitha masat teknike, administrative dhe organizative, gjatë periudhës kontraktuale, në çdo instalim, pjesë të tij, dhe pajisje në mënyrë që të mirëmbajë ose rivendosë gjendjen e punës.



Në rast se pas fillimit të periudhës së garancisë dhe deri në fund të periudhës kontraktuale ndodh një mangësi në funksionimin e instalimeve, pjesëve të tyre dhe pajisjeve që janë pjesë e MKE-ve, kostot e zëvendësimeve dhe dëmeve të tjera që rrjedhin nga mangësi të tilla në funksionimin e MKE-ve (dëmtimet e objektit, pamundësia e zbatimit të masave të tjera të kursimit etj.) do të përballohen nga Kontraktuesi.

7.11 Rishikimi përfundimtar para përfundimit të periudhës kontraktuale

Tre muaj përpara fundit të periudhës kontraktuale, Palët do të rishikojnë së bashku MKE-të. Nëse disa pajisje janë në fund të jetës së tyre dhe/ose kanë arritur fundin e jetës së tyre të projektuar (në përputhje me udhëzimet e prodhuesit), Kontraktuesi do të ndryshojë me shpenzimet e veta pajisje të tilla me pajisje me cilësi të njëjte ose të ngjashme, në mënyrë që ato të jenë plotësisht funksionale në fund të periudhës kontraktuale.

7.12 Verifikimi përfundimtar i dokumentacionit

Në datën kur periudha e garancisë përfundon, Palët Kontraktuese do të nënshkruajnë dokumentin përfundimtar të verifikimit në të cilin ato do të konfirmojnë që të gjitha detyrimet kontraktuale janë përmbushur në kohë.

8. KUSHTET E GARANCISË

Kontraktuesi garanton kryerjen e mirë të të gjitha punëve të kryera sipas kësaj kontrate dhe funksionimin e duhur të elementeve të mëposhtme (duke përfshirë, pa kufizim, instalimet, pjesët e tyre dhe pajisjet e instaluar), si dhe që punët dhe elementet e tillë: (a) janë të rinj dhe të cilësisë të mirë; (b) nuk kanë defekte në projektim, material, dhe punim; dhe (c) janë të përshtatshëm për qëllimin.

Kontraktuesi i garanton klientit performancë të mirë të të gjitha punëve dhe funksionimin e duhur të instalimeve nga momenti i fillimit të periudhës së garancisë dhe deri në fund të periudhës kontraktuale. Në rast të zëvendësimit të pajisjes, pajisja e re e instaluar duhet të jetë të paktën e të njëjtës cilësi si pajisja e zëvendësuar dhe do të jetë në garancinë e siguruar në përputhje me paragrafët 11.1.1 dhe 11.1.2 në vijim.

9. PËRCAKTIMI I KURSIMEVE TË ARRITURA TË ENERGJISË DHE ATYRE FINANCIARE DHE KURSIMEVE TË GARANTUARA

9.1 Metodologjia për përcaktimin e kursimeve të arritura të energjisë dhe kursimeve financiare

9.1.1 Parashikimet e përgjithshme

Një krahasim i kursimeve financiare të matura dhe të verifikuara bazuar në Planin e M & V dhe kursimet e garantuara do të përcaktojë nëse janë arritur kursimet e garantuara.

Një përshkrim i detajuar i metodologjisë se si kursimet e energjisë dhe ato financiare do të llogariten për të gjitha MKE-të është dhënë në Planin e M&V të pranuar nga Palët Kontraktuese në përputhje me këtë kontratë. Formulatat e llogaritjes përfshijnë një metodë për të krahasuar kostot operative, që do të kishin ekzistuar nëse MKE-të nuk do të ishin zbatuar (“kostot operative reference”) me kostot operative pas zbatimit të MKE-ve gjatë periudhës së garancisë.

9.1.2 Monedha referencë

Të gjitha vlerat monetare të llogaritura në bazë të kontratës do të jepen në _____ [të vendoset monedha – (të vendoset monedha lokale) në euro];

9.1.3 Përshtatjet bazë

Përshtatjet bazë për periudhën e garancisë sigurojnë që kursimet e energjisë mund të maten në mënyrë korrekte kundrejt angazhimeve të Kontraktuesit. Në bazë të Planit të M&V, duhet të bëhen dy lloje përshtatjesh:

a) Përshtatjet rutinë – për faktorët që ndikojnë në energji, që pritet të ndryshojnë në mënyrë rutinore gjatë periudhës të raportimit.

b) Përshtatjet jorutinë – për ato faktorë që ndikojnë në energji, që nuk pritet zakonisht të ndryshojnë. Klienti duhet të monitorojë këto faktorë të pandryshueshëm për çdo ndryshim të papritur gjatë periudhës të raportimit.

9.2 Kursimet e garantuara

Kontraktuesi garanton që zbatimi i MKE-ve, nga fillimi deri në fund të periudhës së garancisë, do të reduktojë kostot operative për kompaninë e kontraktuar të paktën në shumën e kursimeve të garantuara, të barabarta me:

_____ lekë [të tregohet monedha referencë-të vendoset monedha lokale në euro]

Në bazë të kontratës, klienti nuk ka të drejtë për pretendime shtesë kundrejt Kontraktuesit, përveç



kursimeve të garantuara dhe gjobave për moszbatim të detyrimit kontraktual.

Kursimet e garantuara vjetore janë të barabarta me kursimet e garantuara pjesëtuar me numrin e viteve në periudhën e garancisë.

9.3 Frekuenca e përcaktimit të arritjes së kursimeve të garantuara

Niveli i arritjes së kursimeve të garantuara do të monitorohet mbi baza tremujore, në mënyrë që të lehtësohet rishikimi vjetor dhe të lejohet veprimi i menjëhershëm, në rast të performancës të ulët, ose të fillojnë përshtatjet Shtesë jo rutinë, kur është e nevojshme.

9.4 Kursimet financiare shtesë

Kursimet financiare shtesë janë diferenca pozitive midis kursimeve financiare të arritura në një periudhë llogaritëse dhe kursimeve vjetore të garantuara. Kursimet financiare shtesë janë baza për pagesë shtesë në përputhje me paragrafin 10.3.

9.5 Kursimet e garantuara që nuk janë arritur si rezultat i performancës së ulët të Kontraktuesit

Kursimet e garantuara që nuk janë arritur janë diferenca negative midis kursimeve financiare të arritura në periudhën llogaritëse dhe kursimeve vjetore të garantuara. Kursimet e garantuara që nuk janë arritur janë baza për llogaritjen e penaliteteve në përputhje me paragrafin 10.4.

9.6 Kursimet e garantuara që nuk janë arritur për shkak të gabimeve të klientit

Nëse MKE-të nuk gjenerojnë reduktimet e parashikuara të kursimeve financiare për shkaqet e krijuara ose që janë nën kontrollin e klientit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) veprimin e gabuar, mosveprimin, shkeljen ose vonesën në përmbushjen e detyrimeve të kontratës nga ana e klientit;

b) vonesat për të cilat Kontraktuesi ka të drejtën të kërkojë shtyrje të afatit;

c) heqjen ose modifikimin e paaautorizuar të MKE-ve nga klienti;

d) ndryshimet materiale ose dëmtime të objektit të kontraktuar ose të pajisjeve dhe sistemeve të klientit ose në funksionimin e tyre, të cilat ndikojnë materialisht në performancën e Projektit ose në shpenzimet e Kontraktuesit në lidhje me performancën e Projektit, siç paraqitet në kuadër të aktiviteteve përgatitore, çështje të tilla do të adresohen në mënyrën e mëposhtme:

- në rast të humbjes së përkohshme të

kursimeve të energjisë dhe kursimeve financiare (më pak se 90 ditë rresht), kursimi financiar do të bazohet në një vlerësim të asaj që do të arrihej nëse një ngjarje e tillë nuk do të kishte ndodhur;

- në rast humbjeje të përhershme të kursimeve të energjisë dhe kursimeve financiare (për më shumë se 90 ditë rresht), Kontraktuesi do të përshtatë konsumin bazë me një shumë të llogaritur për të kompensuar efektin e një ngjarjeje të tillë në kursimet financiare.

10. PAGESAT

10.1 Dispozitat e përgjithshme

Pagesa për kontraktuesin përbëhet nga pagesa bazë dhe pagesa shtesë (fakultative).

Pas miratimit të Regjistrimit të Aktiviteteve në periudhën e zbatimit, Kontraktuesi përfiton të drejtën e pagesës për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës së garancisë.

10.2 Pagesa mujore bazë

Nëse kursimet financiare në një periudhë llogaritëse janë të barabarta me kursimet vjetore të Garantuara, siç demonstron përmes zbatimit të Planit M & V, konsiderohet se me aplikimin e MKE-ve në objektin e kontraktuar, Kontraktuesi përfiton të drejtën e tij për **pagesë mujore bazë** për atë periudhë llogaritëse.

Pagesa mujore bazë është e barabartë me kursimet vjetore të garantuara.

10.3 Pagesa shtesë (fakultative)

Nëse kursimet shtesë arrihen në një periudhë llogaritëse, siç demonstron me anë të aplikimit të Planit M&V, Kontraktuesit i lind e drejta për **pagesë shtesë**.

Shuma e pagesës shtesë mund të llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$(FSCP - AGS) \times RB \quad [\%]$$

ku:

FSCP = Kursimet financiare në periudhën llogaritëse

AGS = Kursimet mujore të garantuara

RB = $\left[\frac{\text{ju lutem të specifikohet përqindja}}{\text{përqindja e pjesës të Kontraktuesit në kursimet e arritura shtesë}} > 50\% \right]$

10.4 Kompensimi në rast të mos arritjes së kursimeve të garantuara ("penalitetet")

Në rast të mosarritjes së kursimeve të garantuara në periudhën llogaritëse për shkak të performancës së dobët të MKE-ve, siç demonstron përmes zbatimit të Planit të M&V, Kontraktuesi do të dënohet me penalitet.



Penalitetet llogariten për çdo periudhë llogaritëse, si vijon:

(AGS-FSCP)

ku:

AGS = Kursimet vjetore të garantuara

FSCP = Kursimet financiare në periudhën llogaritëse

[Fakultative: Në rast se ndarja e kursimeve të garantuara është rënë dakord në përputhje me paragrafin 9.2, gjohet llogariten si vijon:

$$(AGS - FSCP) \times SSP_{Client} \times 2]$$

Vlerësimi i kursimeve të energjisë dhe atyre financiare do të paraqitet nga Kontraktuesi pas çdo periudhë llogaritëse, jo më vonë se 10 ditë pas miratimit të raportit të tremujorit të katërt të M&V përgjatë gjithë periudhës së garancisë.

Shuma totale e gjobave do të duhet të paguhet jo më vonë se _____ [të zgjidhet midis 15 dhe 30 ditëve] pas miratimit të kursimeve vjetore të energjisë dhe atyre financiare, nga Palët Kontraktuese.

10.5 Kryerja e pagesës

Që prej fillimit të periudhës së garancisë, kontraktuesi ka të drejtën të përfitojë një pagesë bazë në përputhje me paragrafin 10.2. Për çdo periudhë llogaritëse me kohëzgjatje prej 12 muajsh gjatë periudhës së garancisë, pagesa paradhënie bëhet në fund të çdo muaji, në shumën e një të dymbëdhjetës së kursimeve vjetore bazë, siç përcaktohet në paragrafin 10.2 të kësaj kontrate, e cila arrin në _____ [shëno monedhën referuese _____ ose euro], përfshirë TVSH-në dhe duke përjashtuar çdo pretendim tjetër.

Në fund të periudhës llogaritëse, Kontraktuesi paraqet raportin vjetor M&V (monitorim dhe verifikim), siç përcaktohet në Planin M&V.

Nëse në bazë të raportit vjetor të paraqitur:

a) janë arritur kursimet shtesë, klienti paguan pagesë shtesë për Kontraktuesin në përputhje me paragrafin 10.3 të kësaj kontrate;

b) kursimet e garantuara në periudhën e llogaritjes nuk janë arritur prej performancës së dobët të MKE-së, Kontraktuesi detyrohet të paguajë gjohet për klientin në përputhje me paragrafin 10.4 të kësaj kontrate;

c) kursimet financiare në periudhën llogaritëse barazohen me kursimet vjetore të garantuara të mbuluara nga pagesa mujore bazë gjatë periudhës llogaritëse, Kontraktuesi ka të drejt të përfitojë pagesë bazë në përputhje me paragrafin 10.2 të

kësaj kontrate dhe nuk do të kryhet asnjë pagesë shtesë ndaj Kontraktuesit.

10.6 Afatet e pagesës

Klienti bie dakord që të paguajë të gjitha shumat e padiskutueshme sipas kësaj kontrate brenda _____ [të zgjidhet midis 15 dhe 30 ditëve] nga data e marrjes të faturës nga Kontraktuesi.

Klienti bie dakord t'i paguajë Kontraktuesit interes për kërkesat monetare të pakontestuara, të cilat nuk janë zgjidhur brenda 45 ditëve nga data e faturës së padiskutueshme, në shumën e përcaktuar në ligjin që rregullon normën e interesit në rast vonese.

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë nga klienti kompensim për moskryerjen në kohë të pagesave të pakontestuara, në shumën e përcaktuar nga ligji që rregullon shlyerjen e detyrimeve financiare në transaksionet tregtare ndërmjet sektorit publik dhe sektorit privat (ndërmarrjet private).

Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë nga klienti kompensim për të gjitha shpenzimet që lindin në transaksionet e tij tregtare si rezultat i pagesës së vonuar të kërkesave monetare të pakontestuara nga ana e klientit.

11. SIGURIMI I PËRMBUSHJES

SË DETYRIMEVE TË KONTRATËS

11.1 Sigurimi i përmbushjes së detyrimeve të Kontraktuesit

11.1.1 Qëllimi, lloji dhe niveli i sigurisë

Për të siguruar kryerjen e aktiviteteve në periudhën përgatitore dhe në periudhën e zbatimit, Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë një garanci bankare ose shoqëri sigurimesh për përmbushje të mirë në shumën prej _____ [përzgjidh shifrën prej 5% deri në 10%] të vlerës totale të kursimeve të garantuara në përputhje me paragrafin 9.2 të kësaj kontrate. Vlera totale e garancisë bankare është llogaritur me formulën në vijim:

GS x (përzgjidh shifrën midis 0.05 deri në 0.10)
ku:

GS = Kursimet e garantuara në përputhje me paragrafin 9.2,

Kontraktuesi i siguron dhe i paraqet klientit garancinë bankare origjinale të parashikuar në paragrafin 1 të këtij paragrafi, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës, me vlefshmërinë që mbaron një muaj pas fillimit të periudhës së garancisë.

Për të siguruar përmbushjen e kursimeve të garantuara dhe për të siguruar pagesën e gjobave



në rast të mosarritjes së kursimeve të garantuara në periudhën kontraktuale, Kontraktuesi është i detyruar të paraqesë një garanci bankare për përmbushje të mirë në shumën prej 5% të vlerës totale të kursimeve të garantuara. Vlera totale e garancisë bankare llogaritet me formulën në vijim:

$$GS \times 0.05$$

ku:

GS = Kursimet e garantuara në përputhje me paragrafin 9.2,

Kontraktuesi siguron dhe i paraqet klientit garancinë bankare origjinale të parashikuar në paragrafin 3 të këtij paragrafi më së voni në datën e fillimit të periudhës së garancisë. Vlefshmëria e garancisë fillon nga data e përfundimit të garancisë, të parashikuar në paragrafin 1 të këtij paragrafi, dhe mbaron një muaj pas përfundimit të periudhës së garancisë. Në rast se Kontraktuesi nuk siguron garancinë bankare origjinale për përmbushjen e kursimeve të kontraktuara pas datës së fillimit të periudhës së garancisë, klienti ka të drejtë të aktivizojë garancinë sipas pikës 1 të këtij paragrafi.

11.1.2 Elementet e domosdoshme të garancisë

Kontraktuesi do të paraqesë një garanci bankare sipas paragrafit 11.1.1 të kontratës, që:

- 1) lëshohet në emër të klientit;
- 2) është e pakushtëzuar;
- 3) është e pakthyeshme;
- 4) është e pagueshme me kërkesën e parë;
- 5) vendos një juridiksion ekskluziv për mosmarrëveshjet që lindin nga lidhja e garancisë me zyrat qendrore/vendin e biznesit.

11.1.3 Kthimi i garancisë

Brenda tetë ditëve nga data e mbarimit të garancisë që siguron kryerjen e aktiviteteve në periudhën përgatitore dhe në periudhën e zbatimit, d.m.th., garancinë që siguron përmbushjen e kursimeve të garantuara, garancia përkatëse do t'i kthehet Kontraktuesit.

12. DETYRIMI

12.1 E drejta e klientit për t'u kompensuar për dëmet e shkaktuara nga Kontraktuesi

Kontraktuesi detyrohet të paguajë dëmet e shkaktuara nga ai ose personat që veprojnë sipas udhëzimeve të tij (pa përjashtuar edhe personat e autorizuar të klientit ose punonjësit e tij) ose dëmshpërblimin për dështimin e tij në arritjen e kursimeve të garantuara.

12.2 E drejta e klientit për t'u kompensuar në rast të dështimit të Kontraktuesit për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në ofertë dhe kontratë

Nëse pas nënshkrimit të kontratës vërtetohet se Kontraktuesi nuk ka përmbushur kushtet e parashtruara në ofertë dhe këtë kontratë, d.m.th. ato detyrime që rrjedhin nga kjo kontratë, shkelja e të cilave përbën shkak për zgjidhjen e njëanshme të kësaj kontrate nga klienti, sipas paragrafit 16.2, Klienti ka të drejtë të kërkojë kompensim për shumën e llogaritur si vijon:

$$GS \times 0.03$$

ku:

GS = Kursimet e garantuara në përputhje me paragrafin 9.2.

Në rast se dëmet materiale që i shkaktohen klientit janë më të mëdha se shuma e gjobave të përcaktuara në paragrafin e mësipërm të këtij paragrafi, klienti ka të drejtën të kërkojë nga Kontraktuesi shumën totale të dëmeve të pësuar.

12.3 E drejta e Kontraktuesit për t'u kompensuar për dështimin e klientit për të mbështetur hartimin dhe zbatimin e MKE-ve

Nëse Klienti, me dashje ose me neglizhencë të theksuar, nuk përmbush detyrimin e tij kontraktual për të bashkëpunuar në përputhje me paragrafin 6.3 të kontratës, shkelja e të cilit përbën shkak për zgjidhjen e njëanshme të kësaj kontrate nga Kontraktuesi sipas paragrafit 16.2, ai është i detyruar:

a) të kompensojë Kontraktuesin për të gjitha dëmet e shkaktuara si rrjedhojë e veprimeve të tilla;

b) të paguajë MKE-të e zbatuara, siç provohet nga verifikimi i Regjistrimit të Aktiviteteve në Periudhën përgatitore dhe Regjistri i Aktiviteteve në Periudhën e Zbatimit, si dhe;

c) të kryejë të gjitha pagesat për MKE-të e zbatuara.

13. SIGURIMI

13.1 Pala përgjegjëse

Për kohëzgjatjen e periudhës kontraktuale, Kontraktuesi do të bëjë sigurimin e MKE-ve deri në vlerën e zëvendësimit të tyre kundër zjarrit dhe të gjitha rreziqeve të tjera që mbulohen normalisht nga një policë gjithëpërfshirëse. Klienti dhe Kontraktuesi do të jenë mbajtësit e përbashkët të policës, me kusht që një politikë e tillë e përbashkët të jetë e disponueshme në tregun përkatës të



sigurimeve (përndryshe, Kontraktuesi do të jetë mbajtës i policës).

Përveç kësaj, Kontraktuesi do të blejë polica të përbashkëta sigurimi në emër të Kontraktuesit dhe të klientit, me kusht që polica të tilla të përbashkëta të jenë në dispozicion në tregun përkatës të sigurimeve (përndryshe, Kontraktori do të jetë mbajtës i këtyre policave), për ngjarjet e siguruara dhe me shumat e siguruara si më poshtë:

1. dëmi për ndërtesën e kontraktuar – shuma maksimale e siguruar [të vendoset], dhe;

2. dëmtimi personal ose vdekja – shuma maksimale e siguruar [të vendoset].

Shpenzimet për sigurimet e sipërpërmendura do të paguhen nga Kontraktuesi.

Nëse Kontraktuesit nuk i bën sigurimet, e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij paragrafi, në fillim të periudhës kontraktuale dhe nuk i siguron klientit dëshmi të kryerjes së sigurimeve dhe pagimit të primeve, klienti ka të drejtë të bëjë në mënyrë të pavarur sigurimet e mësipërme, ndërsa shpenzimet e sigurimeve të paguara nga klienti do të konsiderohen si kërkesë e klientit për t'u paguar nga Kontraktuesi dhe Kontraktuesi është i detyruar të paguajë një shumë të tillë brenda 15 ditëve nga afati i pagesës së tyre.

Të dyja Palët Kontraktuale do të pajtohen me çdo kusht të policave të sigurimit.

13.2 Dëmi

Nëse MKE-të dëmtohen nga një rrezik i siguruar dhe riparimi ose zëvendësimi i tyre është i mundur, të ardhurat nga polica e sigurimit do të shpenzohen për riparim ose zëvendësim dhe Kontraktuesi duhet të plotësojë çdo mungesë.

13.3 Zgjidhja për shkak të dëmit

Pa cenuar dispozitat e tjera të kësaj kontrate, në rast se objekti i kontraktuar është dëmtuar aq shumë sa nuk mund të riparohet, kjo kontratë do të zgjidhet me efekt të menjëhershëm.

14. TRANSFERIMI

DHE NËNKONTRAKTIMI

Klienti ka të drejtë ta transferojë ose të delegojë këtë kontratë dhe të drejtat dhe detyrimet e saj të dhëna më poshtë, një pasardhësi ose blerësi të objektit pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Kontraktori. Çdo transferim ose caktim i tillë nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e Kontraktorit sipas kësaj kontrate dhe klienti do të mbetet bashkërisht me atë të cilit ja ka transferuar ose deleguar dhe individualisht përgjegjës ndaj

Kontraktorit për të gjitha detyrimet e tij si më poshtë.

a) Kontraktori nuk ka të drejtë ta delegojë ose transferojë këtë kontratë ose ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e saj më poshtë te një person tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të klientit;

b) Kontraktori mundet që, me pëlqimin paraprak me shkrim të klientit, pëlqim i cili nuk do të ndalohet në mënyrë të paarsyeshme, të nënkontrakttojë detyrat e tij sipas kësaj kontrate, me kusht që nënkontraktori/ët të jetë në përputhje të plotë me kushtet e kësaj kontrate;

c) Kontraktori do të mbetet plotësisht përgjegjëse për çdo veprim dhe mosveprim të kryer nga nënkontraktori/ët e tij dhe nuk do të shkarkohet nga asnjë prej detyrave ose detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate në lidhje me çdo punim që kryhet nga çdo nënkontraktor.

14.1 Miratimi i përbashkët për kompensimin e efekteve të dëmshme

Në rast të shfaqjes së efekteve të dëmshme në lidhje me transferimin në përputhje me këtë nen 14, Palët Kontraktuese do të negociojnë së pari për të arritur një marrëveshje për përcaktimin e kompensimit të përshtatshëm të Kontraktuesit për këto efekte, nëse dhe kur ai i ka pësuar dëmtimet për shkak të arsyeve të mësipërme.

Në rast se miratimi i përbashkët, sipas paragrafit 1 të këtij paragrafi, do të kërkojë ndryshime të kësaj kontrate, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për prokurimin publik të Republikës së Shqipërisë që rregullon kontratën, Palët Kontraktuese do të lidhin dhe do të bëjnë ndryshimin përkatës të kësaj Kontrate, sipas rregullave të përcaktuara në paragrafin 14.1;

14.2 Kompensimi për Kontraktuesin

Në rast se miratimi sipas paragrafit 14.2 të kësaj kontrate nuk arrihet, ndërtesa e kontraktuar është objekt i transferimit drejt palëve të treta ose nëse përmbushja e detyrimeve të kontratës ndodh dhe për shkak të arsyeve të njëjta marrëdhënia kontraktuale midis klientit dhe Kontraktuesit në lidhje me ndërtesën e kontraktuar përfundon, Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë pagesën për aktivitetet e realizuara prej tij me qëllim zbatimin e MKE-ve, dhe si pasojë përmbushjen e detyrimit kontraktual, në përputhje me llogaritjen e mëtejshme:

1) nëse Kontraktuesi nuk i ka instaluar ende MKE-të në objektin e kontraktuar ose në pjesën e



objektit që u transferua dhe deri në masën e ndërprerjes së marrëdhënies ligjore midis klientit dhe Kontraktuesit në lidhje me këtë pjesë të ndërtesës së kontraktuar, Kontraktuesi do të vendoset në pozicionin sikur efektet e diagnostikuara të MKE-ve u arritën për një pjesë të caktuar;

2) nëse Kontraktuesi i ka instaluar tashmë të gjithë MKE-të në objektin e kontraktuar ose në pjesën e objektit të kontraktuar që u transferua dhe deri në masën e ndërprerjes së marrëdhënies ligjore midis Klientit dhe Kontraktuesit në lidhje me objektin e kontraktuar, Kontraktuesi do të vendoset në pozicionin sikur të gjithë MKE-të u zbatuan në mënyrë të plotë dhe sikur efektet e parashikuara të kursimeve për të njëjtat masa u arritën plotësisht në objektin e kontraktuar.

Vlera e tillë e pranuar do të jetë kompensimi i Kontraktuesit në rastet e pikave 1 dhe 2 të këtij paragrafi.

15. FORCA MADHORE

Në rastet kur ndodhin ngjarjet apo rrethanat që përfaqësojnë forcën madhore, sipas kuptimit të këtij paragrafi, periudha kontraktuale do të pezullohet përkohësisht. Gjithashtu, detyrimet e kësaj Kontrate do të pezullohen përkohësisht deri sa ngjarje dhe rrethana të tilla, që përbejnë forcën madhore, të përfundojnë.

Pala e prekur do të njoftojë menjëherë Palën tjetër me shkrim për ndodhjen, natyrën dhe efektin e ngjarjes së forcës madhore dhe për kohëzgjatjen e mundshme të saj.

Pala e prekur do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të zbutur efektet e ngjarjes së forcës madhore dhe – menjëherë pas ndërprerjes së ngjarjes së forcës madhore – Pala e përmendur do të njoftojë Palën tjetër me shkrim për ndërprerjen e ngjarjes së forcës madhore dhe të rifillojë kryerjen e detyrimeve të saj kontraktuale.

Pas ndërprerjes së forcës madhore, afati i kësaj kontrate do të zgjatët për një periudhë të barabartë me kohën që ka zgjatur forca madhore.

Në rast se ngjarjet dhe/ose rrethanat që përbejnë forcën madhore zgjasin për më shumë se 180 ditë të njëpasnjëshme, të dyja Palët Kontraktuese kanë të drejtë të zgjidhin në mënyrë të njëanshme këtë kontratë, me efekt të menjëhershëm.

Mosarritja për të paguar ndonjë shumë që duhet paguar sipas kësaj kontrate ose mungesa e fondeve

nuk do të përbëjë ngjarje të forcës madhore.

16. ZGJIDHJA E KONTRATËS

16.1 Përfundimi dhe zgjidhja e kontratës

Kontrata përfundon në momentin e përfundimit të periudhës së garancisë, përveç rasteve kur detyrimet specifike, sipas dispozitave të mëposhtme, do të mbesin në fuqi për një periudhë të caktuar kohore pas përfundimit të periudhës së garancisë.

Asnjë Palë Kontraktuese nuk ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme përpara përfundimit të saj, përveç shkaqeve të justifikueshme të përcaktuara në paragrafin 16.2.

Zgjidhja e kontratës nuk do të ndikojë te mjetet e tjera ligjore që janë në dispozicion të Palëve Kontraktuese bazuar në këtë kontratë.

16.2 Zgjidhja e kontratës për shkaqe të justifikueshme

Në rastet e përmendura më poshtë si baza për përfundimin e njëanshëm, klienti do t'i japë Kontraktuesit, kudo që të jetë e mundur, një afat shtesë të arsyeshëm në mënyrë që t'i mundësojë Kontraktuesit të korrigjojë shkeljen e kontratës.

Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë shkeljen e kontratës brenda këtij afati të arsyeshëm pasues, klienti ka të drejtë të ndërpresë kontratën duke dërguar një njoftim me shkrim për përfundimin e kontratës te Kontraktuesi me postë të regjistruar me marrje kthimi.

Kontrata do të konsiderohet e përfunduar pas periudhës prej 15 ditësh kalendarike nga dita e dërgimit të njoftimit për përfundimin e kontratës.

Palët Kontraktuese mund të zgjidhin kontratën në mënyrë të njëanshme vetëm për shkaqe të justifikueshme. Rastet e mëtejshme do të konsiderohen si raste të justifikueshme:

1. Forca madhore në përputhje me dispozitat e paragrafit 15; dhe

2. shkaqe të justifikueshme për klientin:

a) Kontraktuesi vazhdimisht (brenda një periudhe prej [7] muajsh ose me gjatë) dështon në zbatimin MKE-ve të përcaktuara ose të pranuar në këtë dokument.

b) Kontraktuesi bëhet, ose konsiderohet i paaftë të paguajë, ose nuk është i aftë të përmbushë detyrimet e tij për shkaqe të tjera, ose është në procedurat paraprake të falimentimit ose në procedura falimentimi, ose është subjekt i likuidimit vullnetar ose likuidimit të detyruar sipas një procedure të ngjashme në juridiksionin përkatës;



c) Kontraktuesi nuk arrin të sigurojë financimin e objektit kontraktues brenda 12 muajve nga nënshkrimi i kontratës.

3. shkaqe të justifikueshme për Kontraktuesin:

Klienti, me dashje ose prej neglizhencës së theksuar, dështon të përmbushë detyrimin e tij kontraktual për të bashkëpunuar sipas paragrafit 6.3 të kontratës, ose nuk i bën pagesën Kontraktuesit, sipas seksionit 10 të kontratës, për më shumë se tre muaj të njëpasnjëshëm.

16.3 Afati i njoftimit për zgjidhjen e kontratës

Zgjidhja e njëanshme e kontratës dhe të gjitha veprimet e tjera që lidhen me zgjidhjen e kontratës (paralajmërimet, përcaktimi i afatit për zgjatjen e vlefshmërisë së kontratës dhe veprime të tjera) duhet të bëhen vetëm me shkrim, me një afat njoftimi prej të paktën një muaj.

16.4 Dëmet si shkak për zgjidhjen e njëanshme të kontratës

Në rast se klienti zgjidh kontratën në përputhje me dispozitat që rregullojnë shkaqet e justifikueshme për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, siç përcaktohet në paragrafin 16.2 të kësaj kontrate, klienti ka të drejtë të kërkojë kompensim, siç përcaktohet në paragrafin 12.2 të kësaj kontrate.

Në rast se Kontraktuesi e zgjidh kontratën në përputhje me dispozitat që rregullojnë shkaqet e justifikueshme për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, siç përcaktohet në paragrafin 16.2 të kësaj kontrate, Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë kompensim, siç përcaktohet në paragrafin 12.3 të kësaj kontrate.

Nëse njëra nga Palët Kontraktuese zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën, pa shkak dhe në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë shkaqet e justifikueshme për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës, siç përcaktohet në paragrafin 16.2 të kësaj kontrate, Pala tjetër Kontraktuese ka të drejtë të kërkojë kompensim për të gjitha dëmet që vijnë nga zgjidhja e njëanshme e kontratës.

Në rast se njëra nga Palët Kontraktuese kërkon të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën, pavarësisht se Pala tjetër Kontraktuese i ka përmbushur detyrimet e saj kontraktuale në mënyrë të kujdesshme, Pala Kontraktuese që kërkojë zgjidhjen e kontratës detyrohet t'i paguajë Palës tjetër Kontraktuese gjobat që arrijnë në 10% të vlerës së MKE-ve totale të kontraktuara, si dhe ta kompensojë atë për të gjitha dëmet e shkaktuara.

17. LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Kjo kontratë do të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zgjidhur në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga ose në lidhje me këtë kontratë. Çdo mosmarrëveshje që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore do t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatave kompetente shqiptare.

19. KONFIDENCIALITETI

Secila palë do ta trajtojë informacionin e ndjeshëm tregtar të palës tjetër si konfidencial dhe nuk do të japë asnjë informacion të tillë te palët e treta pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

20. KONTRATA

Kjo kontratë, përfshirë të gjitha planet/programet e saj, përbën të gjithë kontratën dhe nuk mund të anulohet, ndryshohet ose zgjidhet përveçse me pëlqimin me shkrim të dyja Palëve.

Kjo kontratë është përgatitur në dy kopje për secilën Palë _____ [shëno datën] nga përfaqësuesit me autorizimin e nevojshëm.

[ju lutem vendosni vendin dhe datën e nënshkrimit]

Për Klientin:

Për Kontraktuesin:

(vula dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar)

(vula dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të autorizuar)



SHTOJCA 2 TË DHËNAT E PALËVE TË KONTRAKTIMIT

Lidhur ndërmjet

Klienti: _____

Adresa: _____

Përfaqësuesi i autorizuar: _____

Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS): _____

Opsionale – (nën) llogaria (e buxhetit): _____

- Më poshtë referuar si: **Klienti**

dhe

Kontraktuesi: _____

Adresa: _____

Përfaqësuesi i autorizuar: _____

Numri i Regjistrimit: _____

Numri identifikues tatimor: _____

Llogaria aktuale: _____

SHTOJCA 3 LISTA E MASAVE TË KURSIMIT TË ENERGJISË (MKE)

Nr.	Masa për përmirësimin e efikasitetit të energjisë	Kostot e vlerësuara të investimit	Kursimet vjetore të vlerësuara	Kursimet e përlogaritura të kostos vjetore
1	Masa 1	Lekë	MWh/vit	[Lekë/ vit]
2	Masa 2			
3	Masa 3			
4	Masa 4			

URDHËR

Nr. 216, datë 4.9.2023

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 21, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a” e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar; për shkak të mungesës në punë për arsye objektive, të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Laerta Rooze, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën 6.9.2023–8.9.2023.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Laerta Rooze.

4. Znj. Laerta Rooze nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë